

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

23 qershor 2009
Prishtinë
Ap.-Kz Nr. 179/2007

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës me Trupin Gjykuës të përbërë nga Gjykatësi Ndërkombëtar Emilio Gatti si Kryetar i Trupit Gjykuës, Gjykatësit Ndërkombëtarë Maria Giuliana Civinini dhe Guy Van Craen dhe Gjykatësit e Kosovës Salih Mekaj dhe Nesrin Lushta si anëtarë të Trupit Gjykuës,


Në lëndën penale kundër:

AI

, në paraburgim që nga 7 prill 2004 deri në lirimin e tij në këtë gjykim më 20 prill 2005, i ngarkuar me aktakuzën e ndryshuar për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë (Neni 30, para. 5, Kodi Penal i Kosovës lidhur me Nenin 22, Kodi Penal FSRJ, lidhur me Nenet 146, 147 para. 5 dhe 6 dhe Neni 23, KPPK), tre vepra penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm (Neni 157, para. 1 dhe 3, KPK lidhur me Nenin 164 para. 2 dhe Neni 22, KP, FSRJ, Neni 291 para. 1, 3, 5 lidhur me Nenin 23, KPPK PÇK), tre vepra penale të pjesëmarrjes në grup që kryen veprë penale (Neni 200, para. 1 KPK lidhur me Nenin 22 KP, FSRJ, Neni 320 para. 1 lidhur me Nenin 23, KPPK).

NR

i mbajtur që nga 5 prill 2004, i ngarkuar me aktakuzën e ndryshuar për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë (Neni 30, para. 5, Kodi Penal i Kosovës lidhur me Nenin 22, KP, RSFJ, lidhur me Nenet 146, 147 para. 5 dhe 6 dhe Neni 23, KPPK), tre vepra penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm (Neni 157, para. 1 dhe 3, KPK lidhur me Nenin 164, para. 2 dhe Neni 22, KP, RSFJ, Neni 291, para. 1, 3, 5 lidhur me Nenin 23, KPPK), tre vepra penale të pjesëmarrjes në një grup që kryen veprë penale (Neni 200, para. 1, KPK lidhur me Nenin 22, KP, RSFJ, Neni 320 para. 1 lidhur me Nenin 23, KPPK).



XJ

ne paraburgim që nga 31 mars 2004, i ngarkuar me aktakuzën e ndryshuar për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë (Neni 30, para. 5, Kodi Penal i Kosovës lidhur me Nenin 22, KP, RSFJ, lidhur me Nenet 146, 147 para. 5 dhe 6 dhe Neni 23, KPPK), tre vepra penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm (Neni 157 para. 1 dhe 3, KPK lidhur me Nenin 164 para.2 dhe Neni 22 KP, RSFJ, Neni 291 para. 1, 3, 5 lidhur me Nenin 23, KPPK), tre vepra penale të pjesëmarrjes në grup që kryen veprë penale (Neni 200 para. 1 KPK lidhur me Nenin 22 KP RSFJ, Neni 320 para. 1 lidhur me Nenin 23 KPPK), vepra penale e posedimit të paligjshëm të armës dhe municionit pa autorizim të ligjshëm (Neni 8.2 dhe 8.6 Rregullorja e UNMIK-ut 2001/7, Neni 328 para. 2 KPPK), vepra penale e pengimit të provave (Neni 177 para. 1, KPK, Neni 309 para. 2, KPPK).

S.S.

ne paraburgim që nga 22 mars 2004 deri në lirim e tij në këtë gjykim më 4 shkurt 2005, i ngarkuar me aktakuzën e ndryshuar për kryerjen e dy veprave penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm (Neni 157 para 1 dhe 3 KPK lidhur me Nenin 164 para.2 dhe Neni 22 KP RSFJ, Neni 291 para. 1, 3, 5 lidhur me Nenin 23 KPPK), tre vepra penale të pjesëmarrjes në një grup që kryen veprë penale (Neni 200 para. 1 KPK lidhur me Nenin 22 KP RSFJ, Neni 320 para 1 lidhur me Nenin 23 KPPK).


ATA

ne paraburgim që nga 7 prill 2004 deri me 28 gusht 2004, i ngarkuar me aktakuzën e ndryshuar me kryerjen e veprës penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm (Neni 157 para 1 dhe 3 KPK lidhur me Nenin 164.2 dhe Nenin 22 KP RSFJ, Neni 291 para. 1, 3, 5 lidhur me Nenin 23 KPPK), tre vepra penale të pjesëmarrjes në grup që kryen veprë penale (Neni 200 para. 1 KPK lidhur me Nenin 22 KP RSFJ, Neni 320 para 1 lidhur me Nenin 23 KPPK).

Duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, vendimi P. nr. 142/2004, i datës 19 maj 2005, duke dënuar A1 (i) NR për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë të paraparë me Nenet 146 dhe 147, pika 5 lidhur me Nenin 23 KPPK, A1 (ii) XJ për kryerjen e veprës penale të dhënies së ndihmës në vrasje të rëndë të paraparë me Nenet 146 dhe 147, pika 5 lidhur me Nenin 25 KPPK, A2 AI JJ

NR AA

SB XJ për kryerjen e veprës penale të



piesëmarrjes në grup që kryen veprë panel të paraparë me Nenin 200.1 LPK, *XS*
për kryerjen e veprës penale të autorizimit të paligjshëm të armës të paraparë
me pjesën 8.2 lidhur me pjesën 8.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/7,

Ankesat e parashtruara nga avokatët mbrojtës
Për *SS* më 26 janar 2007,
Për *NR* në 12 dhjetor 2006,
Për *XS* më 7 dhjetor 2006,
Për *AI* në 31 dhjetor 2006,
Për *AA* më 12 dhjetor 2006,

Pas dëgjimit të kërkesave të avokatëve mbrojtës Zt. Mustafe MUSA, Zt. Arben MUSTAFA, Zt. Shemsedin PIRAJ, Zt. Masar MORINA dhe Zt. Faruk BRESTOVIC, deklaratat e të pandehurve dhe mendimin dhe kërkesën e ZPSK Prokurori Zt. Theo JAKOBS në seancën e mbajtur më 23 qershor 2009 dhe pas shqyrtimit për marrje të vendimit dhe votimit të mbajtur më 23 qershor 2009.

Në pajtim me Nenin 420 të Kodit të procedurës Penale të Kosovës (KPPK) shpall këtë

VENDIM


Ankesa e ushtruar në interes të *AI*, më datën 31 dhjetor 2006, REFUZOHET.

Ankesa e ushtruar në interes të *NR*, më datën 12 dhjetor 2006 PRANOHET pjesërisht sa i përket kualifikimit ligjor të veprës penale të vrasjes së rëndë sipas Nenit 30 paragrafi 2 pika 5 të LPK dhe REFUZOHET pjesa e mbetur.

Ankesa e ushtruar në interes të *XS*, më datën 7 dhjetor 2006 PRANOHET pjesërisht sa i përket veprës penale të dhënies së ndihmës në vrasje të rëndë nga i cili i pandehuri **LIROHET NGA AKLUZA** edhe sa i përket dënimit, i cili zvogëlohet në dy vite dhe shtatë muaj burgim për veprat penale të tjera.

Ankesa e ushtruar në interes të *SS*, më datën 26 janar 2007 REFUZOHET.

Ankesa e ushtruar në interes të *AA*, më datën 12 dhjetor 2006 REFUZOHET.



Në pajtim me Nenin 391.5, KPPPK, koha e kaluar në paraburgim nga secili i pandehur është e përfshirë në masën e dënimit.

Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilanit, i datës 19 maj 2005, P Nr. 142/2004 KONFIRMOHET NË PJESËN TJETËR.

Shpenzimet e procedurës së shkallës së dytë ndahen në mes të pandehurve.

Një vendim i veçantë është sjellur mbi paraburgimin për ' dhe sipas Nenit 426 dhe 393 KPPK.

NR


XS'



ARSYETIMI

A. Prapavija procedurale

1. Kundër ^{AI} ^{NR} ^{JB} ^{XJ}
^{SS} dhe ^{AA} Prokurori Ndërkombëtar Publik
ngriti aktakuzë më datën 28 shtator 2004 për akuzën e vrasjes së rëndë, dy vepra penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm, dy vepra penale të pjesëmarrjes në grup që kryen veprë penale, përderisa ^{XJ} është akuzuar edhe me veprën penale të posedimit të paligjshëm të armës dhe municionit dhe veprës penale të pengimit të provave.
Pretendimet kanë të bëjnë me vrasjen e ^{SP} dhe lëndimet e mëdha që ka pësuar e ëma e tij ^{AP} në 17 mars 2004 në Gjitan.
Për gjashtë të pandehurit, aktakuza është konfirmuar në të gjitha pikat e saj me vendimin e sjellur më 14 tetor 2004.
2. Shqyrtimi kryesor filloi më 25 janar 2005, është mbajtur në praninë e Prokurorit Publik, të të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës dhe përfshiu 25 seanca deri më 19 maj 2005.
Në seancën e mbajtur më 12 maj 2005, Prokurori ndryshoi aktakuzën e tij duke ngarkuar kështu:
1. ^{AI} ^{NR} ^{CR} dhe ^{XJ}
me veprën penale të vrasjes së rëndë të ^{SP}
2. ^{AI} ^{NR}, ^{JB}, ^{SS}, ^{XJ}
me veprën penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm me anë të një veprimi të përgjithshëm të rrezikshëm kundër ^{SP}
3. ^{AI}, ^{NR}, ^{JB}, ^{SS}, ^{XJ}, ^{AA}
me veprën penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm me anë të një veprimi të përgjithshëm të rrezikshëm kundër
4. ^{AI}, ^{NR}, ^{AP}, ^{JB}, ^{SS}, ^{XJ}, ^{AA}
me veprën penale të pjesëmarrjes në grup që privoi nga jeta ^{SP}
5. ^{AI}, ^{NR}, ^{JB}, ^{SS}, ^{XJ}, ^{AA}
me veprën penale të pjesëmarrjes në grup që shkaktoi lëndime të mëdha ^{AP}
6. ^{XJ}
me veprën penale të posedimit të paligjshëm të armës dhe municionit pa autorizim të ligjshëm,
7. ^{XJ}
me veprën penale të pengimit të provave.
8. ^{AI} ^{NR} ^{JB} ^{SS} ^{XJ} ^{AA}
me veprën penale të pjesëmarrjes në grup që shkaktoi dëmtim të konsiderueshëm pronës së ^{SP} dhe ^{AP}
9. ^{AI}, ^{NR}, ^{JB}, ^{SS}, ^{XJ}, ^{AA}
me veprën penale të shkakimit të



rezikut të përgjithshëm me anë të zjarrit gjë që shkaktoi rrezik thelbësor pronës së
n dhe, i. AP

Në seancën e mbajtur më 19 maj 2005, është shpallur vendimi.

NR është shpallur fajtor për vrasje të rëndë të ;
XS është shpallur fajtor për dhënie ndihme në vrasjen e rëndë të ;

AI, SP, NR, SB, JJ, XP, AA janë shpallur fajtorë për pjesëmarrje në grup që
privoi nga jeta Slobodan Pericin, shkaktoi lëndime të rënda trupore AP dhe
XS dëmtoi në mënyrë të konsiderueshme shtëpinë e SP dhe së paku një veturë,
është shpallur fajtor për posedimin e paligjshëm të armës dhe
municionit.

NR është dënuar me dënimin total prej 16 vite burgim,
XS me dënimin total prej 11 vite burgim duke marrë në konsideratë një
dënim të revokuar,
SB me dënimin total prej 3 vite dhe 6 muaj burgim duke marrë në
konsideratë dy dënime të revokuara,
AI me dënimin prej 2 vite dhe 6 muaj burgim,
SS me dënimin prej 2 vite dhe 6 muaj burgim,
AA me dënimin prej 2 vite dhe 6 muaj burgim.

Të pandehurit janë liruar nga akuzat e tjera.

AI 3. / është arrestuar më 7 prill 2004 dhe është liruar në këtë shqyrtim më
20 prill 2005. NR

SB është arrestuar më 5 prill 2004, paraburgimi është zgjatur derisa
vendimi bëhet i plotëfuqishëm me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, datës 19 maj
2005.

XS është arrestuar më 29 mars 2004, paraburgimi është zgjatur derisa
vendimi bëhet i plotëfuqishëm me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, datës 19 maj
2005.


SS është arrestuar më 31 mars 2004, paraburgimi është zgjatur derisa
vendimi bëhet i plotëfuqishëm me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, datës 19 maj
2005.

AA është arrestuar më 22 mars 2004 dhe është liruar në këtë shqyrtim më 4
shkurt 2005.

J është arrestuar më 7 prill 2004 dhe është liruar më 28 gusht 2004.

4. Avokatët Mbrojtës të personave të dënuar kanë ushtruar ankesë kundër vendimit si në
vijim.

Ankesa e Zt. Faruk BRESTOVCI si Avokat Mbrojtës i të pandehurit AI
është ushtruar më 31 dhjetor 2006.



Ankesa e Zt. Arben MUSTAFA si Avokat Mbrojtës i të pandehurit është ushtruar më 12 dhjetor 2006.

NR

Ankesa e Zt. Mustafe MUSA si Avokat Mbrojtës i të pandehurit është ushtruar më 26 janar 2007.

SS

është

Ankesa e Zt. Shemsedin PIRAJ dhe Zt. Masar MORINA si Avokatë Mbrojtës të të pandehurit është ushtruar më 7 dhjetor 2006.

XJ

Ankesa e Zt. Azis R. SHAQIRI si Avokat Mbrojtës i të pandehurit është ushtruar më 12 dhjetor 2006.

AA

SK

nuk ushtroi ankesë.

Mendimi i Prokurorit Ndërkombëtar është shprehur më 28 janar 2009.

5. Pas dhënies së lëndës gjykatësve të EULEX-it në janar 2009, Gjykata Supreme e Kosovës caktoi seancën e ankimimit më 23 qershor 2009, me ç'rast Kryetari i Trupit Gjykues bëri raportin e tij, të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës parashtruan ankesat e tyre, Prokurori Ndërkombëtar janë kundërpërgjigjur, dhe në fund avokatët mbrojtës dhe të pandehurit dhanë fjalën përfundimtare siç lexohet në procesverbal.

6. Trupi Gjykues është tërhequr për diskutim më 23 qershor 2009.

B. Çështjet e ngritura nga ankimuesit

I

Fillimisht, është e nevojshme të trajtohen ca çështje të përbashkëta për ankimuesit apo të duhet të hetohen ex officio.

1. Sa i përket shkeljes së procedurës penale.

Pika e parë që ngritet nga ankesat dhe që duhet të trajtohet edhe ex officio, sipas Nenit 415.1, nënparagrafi 1 lidhur me Nenin 403.1, nënparagrafi 8, KPPPK, është pranueshmëria e provës së përdorur nga ana e Gjykatës së shkallës së parë për të bazuar vendimin.

Çështja ngritet në veçanti nga ana e deklaratave të bëra nga të pandehurit në polici.

1.1 Siç është thënë edhe në vendimin e ankimuar, hetimet e lidhura me këtë lëndë filluan më 25 mars 2004.



Në pajtim me Nenin 549, KPPPK “hetimet e nisura para hyrjes në fuqi të Kodit aktual, por të cilat nuk janë përfunduar para kësaj date, do të vazhdoen dhe të përfundohen sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm që ishte në fuqi”.

KPPPK është futur në fuqi më 6 prill 2004.

Kjo do të thotë që të gjitha fazat hetuese është dashur të vazhdoen dhe të përfundohen sipas procedurës penale në fuqi para KPPPK, pra sipas LPK.

Neni 218, LPK parasheh rregullat e marrjes në pyetje të të akuzuarit¹, i cili duhet të informohet lidhur me akuzën dhe arsyet për dyshimin ndaj tij, të ftohet të zbulojë mbrojtjen e tij dhe të informohet “që nuk ka për obligim që të shpalosë argumentet e mbrojtjes së tij dhe të mos përgjigjet në pyetjet që shtrohen”(paragrafi 2).

Dispozita e paragrafit 8 përjashton mundësinë e përdorimit të “forcës, kërcënimit apo metodave të ngjashme” për të marrë nga i akuzuari një deklaratë apo rrëfim.

Paragrafi 9 parasheh që “i akuzuari mund të merret në pyetje në mungesë të avokatit të tij mbrojtës nëse i pari në mënyrë eksplicite hoqi të dotë nga kjo e drejtë dhe mbrojtja nuk është mandatore”.

Neni 67.1, LPK parasheh që i akuzuari “mund të ketë avokat mbrojtës gjatë gjithë procedurës penale” dhe neni në vijim, ai 70 parasheh rastet kur mbrojtja është e detyrueshme.

Paragrafi 1 i Nenit 70 parasheh obligimin (“detyrimin”) e pranisë së avokatit mbrojtës “që nga hera e parë e marrjes në pyetje” nëse i pandehuri është memec, i shurdhër, apo nuk është në gjendje që të mbrojë veten e tij në mënyrë efektive apo nëse procedura bëhet për një vepër penale për të cilën mund të shpallet dënimi kapital.

Paragrafi i dytë parasheh praninë e detyrueshme të mbrojtjes vetëm që nga koha kur sjellet aktakuza në rast të ndonjë akuze për të cilën dënimi prej burgimit prej 10 vitesh mund të shpallet.

Asnjë dispozitë e LPK-së nuk sjellë një mbrojtje mandatore bazuar vetëm në mbrojtjen e të pandehurit.


Në rastin specifik, sipas dispozitave të LPK-së, para ngritjes së aktakuzës, prania e avokatëve mbrojtës duke u ndihmuar të pandehurve gjatë marrjes në pyetje nuk ishte mandatore dhe të pandehurit vetë mund të heqin dorë nga kjo e drejtë.

Kjo për shkak se asnjë i pandehur nuk përmbushte ndonjë kusht të paaftësisë të përmendur në paragrafin e parë të Nenit 70 dhe akuzat nuk mund të sjellnin në bindjen për dënimin me vdekje².

Nga dosja e lëndës del që vetëm XS ka dhënë deklaratë në polici në prani të avokatit të tij³: asnjë koment mbi papranueshmërinë e këtyre deklaratave janë ngritur gjatë ankimit dhe as që do të jenë ex officio.

¹ Këto rregullore janë “të vlefshme për intervistimin e të akuzuarit në çdo fazë të procedurës dhe nga çdo autoritet, i autorizuar për të intervistuar të akuzuarin (autoritetet e punëve të brendshme)”. shihni Branko PETRIC Komentari mbi Ligjin e Procedurës Penale, Neni 218.

² Dënimi me vdekje, fillimisht e paraparë me Nenin 30.2, pika 5 e Kodit Penal të Kosovës për rastin e vrasjes së rëndë, është shfuqizuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 Neni 1.5, ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59. Dispozita e fundit zëvendësoi dënimin me vdekje me dënimin me burgim, maksimumi i të cilit është katërdhjetë vite.



Në anën tjetër, të pandehurit e tjerë janë dëgjuar pa praninë e avokatëve të tyre mbrojtës duke qenë se ata në mënyrë eksplicite kanë hequr dorë nga kjo e drejtë.

1.2 Faza hetuese është ndërmarrë nga SHPK dhe Policia e UNMIK-ut, të cilat kishin për detyrë të respektojnë dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2001/28 mbi të drejtat e personit të arrestuar nga Autoritetet për Zbatim të Ligjit dhe të Rregullores së UNMIK-ut 2002/7 mbi marrjen në pyetje nga ana e Autoriteteve për Zbatim të Ligjit.

Rregullorja e parë parasheh të drejtën për të qenë i informuar mbi arsyet e arrestimit, të drejtën për të heshtur dhe për të mos u përgjigjur në pyetje, të drejtën për të pasur avokat mbrojtës (pjesa 2.1).

Të drejtat e tij duhet të i komunikohen personi të arrestuar në mënyrë gojore menjëherë pas arrestimit si dhe me shkrim (pjesa 2.2).

Pjesa 2.3 në mënyrë specifike parasheh që në çastin para marrjes në pyetje personi i arrestuar duhet të jetë i informuar mbi të drejtën e tij për të qëndruar i heshtur dhe për të pasur një avokat mbrojtës.

Pjesa 3.4 përsërit të drejtën e personit të arrestuar për praninë e avokatit mbrojtës “gjatë të gjitha intervistimeve që bëhen nga autoritetet për zbatim të ligjit”.

Pjesa 3.6 parasheh mundësinë që i pandehuri të heqë dorë nga prania e avokatit mbrojtës “nëse një heqje dore e tillë bëhet në një mënyrë të informuar dhe vullnetare”.

Pjesa 2 e Rregullores së UNMIK-ut 2002/7 parasheh të drejtën e personit që merret në pyetje të lexojë apo t’i lexohet procesverbali me shkrim i cilësdo interviste.

Pas përfundimit të leximit, intervistuesi “nënshkruan procesverbalin e shkruar të një interviste, nëse ai apo ajo e sheh si të saktë”.

Pjesa 3 parasheh kushtet në të cilat Gjykata mund të përcaktojë që proces-verbali me shkrim i një interviste mund të përdoret për të sjellë vendim.

Në mesin e kushteve të tjera përshkruhet që gjatë një interviste “nuk është përdorur forca, kërcënimi apo metoda të tjera të ngjashme nga ana e autoriteteve për zbatim të ligjit për marrjen e deklaratës”.

1.3 Në përfundim të hetimit, Prokurori Publik ngriti aktakuzën më 28 shtator 2004.

Si rrjedhojë dhe në pajtim me Nenin 550, KPPPK, shqyrtimi kryesor dhe fazat pasuese rregullohen nga ana e KPPPK-së.

Neni 156.1 i këtij Kodi parasheh vlerësimin që duhet të jepet deklaratës së dhënë nga i pandehuri në Polici duke pranuar kështu se kjo provë vlerësohet si e pranueshme në rastet kur ajo merret në pajtim me Nenin 229 deri 236.

Për më tej, Neni vijues 157.2 parasheh që “gjykata do të shpallë të akuzuarin të fajshëm bazuar vetëm në apo në nivel vendimtar mbi deklaratat e dhëna nga të pandehurit në polici apo prokurori publike”.

Dispozitat e Neneve 229 deri 236, KPPPK janë të njejta sikurse ato të LPK-së sa i përket informatave për veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri, të drejtën për të qëndruar në heshtje dhe të mos u përgjigjur në pyetje dhe të drejtën “për të pasur avokat

³ Kjo rezulton nga Raporti hetues lidhur me këtë intervistë, ku citohet prania e avokatit Z. Masar MORINA, nga deklarata e dëshmitarit MU dhënë Gjykatësit Hetues, deklaratë e lexuar gjatë shqyrtimit kryesor sipas Nenin 368, KPPPK dhe nga pretendimet e të pandehurit në seancën e shkurtit 2005.



mbrojtës dhe të konsultohet me të para apo gjatë intervistimit” (Neni 231.2 pikët 1, 2, 4 dhe nënparagrafi 3).

Kapitulli XXIV, KPPPK parasheh dispozitat mbi arrestimin e përkohshëm dhe mbajtjen në polici të të dyshuarit.

Policia ka mundësinë për të ekzaminuar personin e arrestuar (Neni 218), në pajtim me dispozitat nga Nenet 231 deri 235.

Në mesin e të tjerave, personi i arrestuar ka të drejtë për asistim të menjëhershëm nga avokati mbrojtës (Neni 213, paragrafi 1), e drejtë nga e cila mund të hiqet dorë në pajtim me Nenin 69 paragrafët 3, 4 dhe 5 të kodit të njejtë (Neni 213 paragrafi 4).

Neni 69.3 KPPPK lejon të dyshuarin⁴ dhe të pandehurin që të heqin dorë nga e drejta për avokat mbrojtës “përpos në raste të mbrojtjes mandatore”, ku sipas Nenit 73.1 ka të bëjë me kushtet e paaftësisë së të pandehurit⁵, të zbatimit të paraburgimit⁶ apo të ngritjes së aktakuzës për një vepër penale të dënueshme me të paktën tetë vite burgim.

Asnjë dispozitë e KPPPK-së nuk parasheh ndonjë rast të mbrojtjes mandatore bazuar vetëm në arrestimin e përkohshëm të të pandehurit nga ana e policisë.


Kjo do të thotë që sipas KPPPK-së, në rast të intervistimit në polici gjatë procedurës paraprake dhe për akuza të tilla, i akuzuari dhe i pandehuri, edhe nëse të arrestuar kanë mundësinë të heqin dorë nga e drejtë e tyre për praninë e avokatëve mbrojtës.

Kjo do të thotë që, sipas KPPPK, deklaratat e dhëna nga të pandehurit në polici pa praninë e avokatëve të tyre mbrojtës konsiderohen si “prova të pranueshme” në gjykatë gjithnjë nëse është hequr dorë nga kjo në mënyrë të vlefshme.

Sipas Nenit 69.3, KPPPK, heqja dorë e vlefshme nga avokati mbrojtës në këto kushte është kur “bëhet në mënyrë eksplicite, të informuar dhe vullnetare”, të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga i dyshuari apo i pandehuri dhe nga autoriteti kompetent dëshmues.

Për më tej, Neni 155, KPPPK gjatë secilës marrje në pyetje ndalon çdo lloj forme të keqtrajtimit, ndërhyrjes fizike apo detyrimit, krijimin e kapitjes tek i pandehuri, kërcënimit e tij me mjete të palejueshme me ligj dhe zgjatjen e një përparësia që nuk e parasheh ligji.

Shkelja e ndalimeve të përfshira në Nenin 155 rezulton në papranueshmërinë e provave të mbledhura.

1.4 Ankesa e  rrëfen për shkeljen e të drejtave të të pandehurit gjatë dhënies së deklaratës në polici më 22 mars 2004.

Ankesa pretendon që sipas të drejtave të personit të arrestuar, formularit 22 mars 2004, pika 7, i pandehuri është përgjigjur me “JO” në pyetjen “a dëshironi të heqni dorë nga e drejta për të qëndruar i heshtur tani me ne”.

Kjo do të thotë që ky dëshiroi të qëndrojë i heshtur dhe që policia e ka detyruar atë të japë deklaratë.

⁴ Sipas Nenit 151, KPPPK “i dyshuari” është personi kundër të cilit Policia apo Prokuroria Penale ka dyshim të arsyeshëm që ka kryer vepër penale, por kundër të cilit procedura penale akoma nuk është nisur, ndërsa “i pandehuri” është personi kundër të cilit procedura penale ka nisur.

⁵ Mbrojtja është mandatore “që nga ekzaminimi i parë” nëse i pandehuri është memec, i shurdhër, shfaqë shenja të çrregullimit mendor, apo paaftësisë dhe prandaj nuk është në gjendje të mbrojtë veten.

⁶ Mbrojtja është mandatore “në seancat për paraburgim dhe gjatë gjithë kohës që ai apo ajo është në paraburgim”.



Së dyti, intervistimi, pa ndonjë pushim ka zgjatur nga ora 12:30 deri në 14:45, si pasojë e së cilës, i pandehuri ka qenë "i rraskapitur" dhe "jo në gjendje të ketë nën kontroll atë se çfarë e thotë dhe të mos e nënshkruajë".

Gjykata e Shkallës e Parë shqyrton këto pika në faqet 42-44 duke marrë parasysh formularin mbi të drejtat e personit të arrestuar, dorëzuar më 22 mars 2004 nga i pandehuri, dëshminë e hetuesve të policisë BT dhe MU dhe ato të dëshmitarëve të tjerë gjithashtu, pretendimet e bëra nga ana e te pandehurit gjatë shqyrtimit kryesor dhe si përfundim vendos që të drejtat e të pandehurit nuk janë shkelur dhe pretendimet e të pandehurit duken si të "shpikura" "në përpjekje për të mbrojtur veten pas dhënies së dëshmisë nga të bashkë-akuzuarëve të tjerë".

Kjo Gjykatë ka mendim të njëjët me Gjykatën e Shkallës së Parë.

Pika fillestare është ekzaminimi i formularit të të drejtave të personit të arrestuar, dorëzuar më 22 mars 2004 nga i pandehuri para dhënies së deklaratës së tij të parë në Polici.

Ky formular përmban dy rradhë pyetjesh: së pari 10 pyetje dhe pastaj 5 të tjera.

Disa pyetje janë përsëritur, dhe pjesërisht janë formuluar në mënyrë të ndryshme.

Pyetja numër 7 e rradhës së parë është "a dëshironi të heqni dorë nga e drejta e juaj për të qëndruar i heshtur këtu me ne?"

Në këtë rast, përgjigja në versionin në gjuhën shqipe (origjinale) është "JO" ("JO").

Pyetja numër 8 është "a dëshironi të konsultoi me avokatin e juaj mbrotjës?"

Këtu nuk është rumbullakësuar asnjë përgjigje.

Tani, forma përmban ca udhëzime ligjore për autoritetin veprues lidhur me të drejtat e të pandehurit për të qëndruar i heshtur, nevojën për të kontaktuar avokatin e tij mbrotjës apo në rast se i pandehuri heq dorë nga e drejta e tij për të qëndruar i heshtur dhe të përfaqësohet nga avokat mbrotjës, mundësinë që të vazhdojë intervistimi.

Pjesa e dytë e formularit përmban pesë pyetje.

Pyetja e parë është "jam udhëzuar mbi të drejtat e mia në gjuhën time amtare", përgjigja e është fjala "PO" ("PO").

Pyetja 4 është "unë i kuptoj të drejtat e mia dhe tani dëshiroj të bisedoj me policinë", përgjigja është fjala "PO" ("PO").


Pyetja 5 është ajo "a dëshironi të konsultoheni me avokatin e juaj?", përgjigja është fjala "JO" ("JO").

Ky formular lë të kuptohet që pyetjet janë shtruar, trajtuar dhe përgjigjur nga një nga një.

Nëse në fillim, (atëbotë) përgjigja e tij në pyetjen nr. 7 ishte JO, ai më vonë i është përgjigjur me PO pyetjes "unë i kuptoj të drejtat e mia dhe tani dëshiroj të flas me policinë".

Në këtë rast, fjala tani duket vendimtare sepse pas një përgjigje fillestare negative, i pandehuri ka ardhur deri te përfundimi që i ka kuptuar të drejtat e tij dhe tani në mënyrë vullnetare dëshiron të flet me policinë.

Mungesa e përgjigjes në pyetjen 8 të pjesës së parë nuk duket si gjë vendimtare sepse pyetja e njejtë është përsëritur (nr. 5 e pjesës së dytë) dhe i pandehuri është përgjigjur me një "JO" të qartë.



Ky formular na sjellë deri te vullneti i qartë dhe përfundimtar i [S] më 22 mars 2004 që dëshiron të flasë me Policinë pa praninë e avokatit të tij mbrojtës. Ky formular është nënshkruar nga i pandehuri, gjë që konfirmon se ajo përfaqëson vullnetin e tij.

Vlerësimi i këtij formulari përmbushë kërkesat e Nenit 69.3 për një heqje dore të vlefshme për avokat mbrojtës.

Kjo heqje dore është me shkrim dhe është e nënshkruar nga i dyshuari si dhe nga autoriteti dëshmues.

Pyetja lidhur me dëshirën për të konsultuar avokatin përsëritet dhe i pandehuri është përgjigjur me JO dhe pas kësaj, ai në mënyrë eksplicite deklaroi që të drejtat e tij i janë udhëzuar në gjuhën e tij amtare dhe që i ka kuptuar këto.

Prandaj, është hequr dorë nga e drejta në fjalë në mënyrë të informuar dhe vullnetare.

Kjo nuk e bën të nevojshme vlerësimin e sqarimit të ofruar nga dëshmitari [S] BT

[S] ku ai thotë që gjatë plotësimit të formularit, në pyetjen nr. 7 të pjesës së parë gabimisht është rumbullakësuar "JO" në vend të asaj "PO" ngase asnjëherë nuk ka ekzistuar asnjë dyshim që [S] mund të mos dëshiroj të merret të pyetje nga Policia.

Nëse përgjigja e parë do të mund të interpretohej si gabim i bërë nga zyrtari i Policisë, përgjigja e dytë (ndaj pyetjes 4 të pjesës së dytë) nuk lë vend për dyshim ngase i pandehuri i kupton të drejtat e tij dhe "tani" dëshiron të flasë me Policinë.

Vullneti i të pandehurit për të biseduar me policinë konfirmohet nga elementet e tjera të dokumenteve.

Më 22 mars 2004, [S] është iternvistuar dy herë nga Policia: hera e parë ka filluar në 12:30 dhe përfunduar në 16:45; hera e dytë ka filluar në 06:30 (18:30) dhe përfunduar në 08:00 (20:00).

Ekzaminimi i versionioni (origjinal) shqip i që të dy deklaratave të [S] lejon veçimin e nënshkrimit të të pandehurit.

Sipas Pjesës 2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/7, në fund të leximit, i iternvistuari "nënshkruan procesverbalin e shkruar të intervistës nëse e pranon si të saktë".

Kjo do të thotë që [S] i ka pranuar deklaratat si të sakta duke i nënshkruar ato.

Raporti Hetues i sjellur nga Hetuesi Ndërkombëtar [MV] më 24 mars 2004 në mënyrë narrative rrëfen që ditën e mëparshme (23 mars) raportuesi dhe një koleg kanë kontaktuar [S] në vendin ku është mbajtur.


Në këtë rast (23 mars) [S] i tha [S] që ka përpiluar një raport lidhur me bisedën e tyre ditën e mëparshme (22 mars, pra ditën e dy intervistave në polici).

Zyrtari i Policisë pyeti [S] se a dinte ky shkrim-lexim, përgjigja ishte pozitive, kty shtoi që ka kryer shkollën.

[S] lexoi raportin në gjuhën shqipe dhe konfirmoi që e kuptoi atë.

[S] pyeti [S] se a ishte raporti i vërtetë dhe i saktë dhe i pandehuri i konfirmoi si të tilla.

Zyrtari i Policisë kërkoi që i pandehuri të nënshkruajë raportin, dhe [S] faqen e fundit të këtij raporti në versionin në gjuhë shqipe.



Në fakt, dosja e lëndës përmban një Raport Hetues (të datës 22 mars 2004) të dorëzuar nga ^{MU} lidhur me dy intervistat e dhëna nga ^S që ditën e njëjtë, kjo përmban edhe ca tekst të disa pyetjeve dhe përgjigjeve. Faqja e fundit e versionit në gjuhën shqipe përmban nënshkrimin e ^{SS} datën 23 mars 2004 dhe kohën prej 10:14 paradite. Edhe ky nënshkrim konfirmon që në pajtim me Pjesën 2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/7, ^S ka pranuar raportin dhe deklaratat e cituara në të si të sakta.

Pjesa e dytë e Raportit Hetues, datës 24 mars 2004, reflekton përpjekjet e ^{MU} (më 23 mars) për t'i shtruar pyetje të tjera të reja ^S Para shtrimit të pyetjeve, Zyrtari i Policisë pyeti të pandehurin nëse ky i fundit dëshiron praninë e avokatit. Përgjigja kësaj rradhe, ishte që ^S - I nuk pranoi të flasë me Policinë pa biseduar me avokatin.

^U heqë dorë nga intervistimi.

^S Siç është vënë re edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë (faqe 44), kjo tregon që në atë çast, ishte i vetëdijshëm mbi të drejtën e tij për avokat.

Për më tej, edhe një Raport Hetues nga Hetuesi Ndërkombëtar ^{-MU} më 23 mars 2004 konfirmon që më 22 mars, ^S fillimisht është informuar mbi të drejtat e tij dhe mbi qëllimin e intervistimit dhe që ka pranuar të bisedojë me policinë pa praninë e avokatit të tij mbrojtës.

E njëjta gjë konfirmohet nga ^{MU} gjatë deklaratave të dhëna para Gjykatësit Hetues më 8 prill 2004.

Gjatë shqyrtimit kryesor, ^S pretendon që është keqtrajtuar nga Policia gjatë intervistimit.

Ai thotë që ka qenë i rraskapitur dhe mentalisht i ngarkuar, për këtë arsye, atij i kujtohet që ka nëshkruar diçka, por nuk është në gjendje të kujtohet se çfarë ishte kjo e as se çfarë i ka thënë policisë dhe as se a ka lexuar ndonjë gjë.

Nuk i është kujtuar se a ka pranuar vullnetarisht që të flasë me Policinë atë ditë. I kujtohet që Policia e ka akuzuar për armë dhe i kujtohet që është përgjigjur duke thënë se nuk din asgjë.

Të gjitha këto pretendime janë mohuar nga dëshmitarët e Prokurorisë (Zyrtarët e Policisë dhe Përkthyesit), siç edhe është vlerësuar me themel nga Gjykatësi i Shkallës së Parë.

Duhet të sjellet në pah që i pandehuri nuk ka përmendur asnjë lloj keqtrajtimi nga ana e Policisë kur është intervistuar nga Gjykatësi Hetues më 25 mars 2004, në praninë e avokatit të tij mbrojtës dhe atë të Prokurorit Publik.

Gjatë shqyrtimit kryesor, në pyetjen e Prokurorit se pse ky nuk e përmendi keqtrajtimin dhe kërcënimet e policisë të Gjykatësi Hetues, fillimisht ^S është përgjigjur duke thënë "nuk e di".

Ai supozon që i ka thënë Gjykatësit Hetues që çdo gjë ishte vetëm gënjeshtar dhe që në atë çast, ai priste më shumë pyetje lidhur me këtë.



Prokurori vërejtë që Gjykatësi Hetues e kishte pyetur atë nëse kishte edhe diçka tjetër për të thënë dhe përgjigja e të pandehurit ishte vetëm “jo”.

Vetëm në atë çast gjatë shqyrtimit kryesor, S s qarroi që nuk i kishte përmendur keqtrajtimin Gjykatësit Hetues nga frika se do të rrahej sërish sepse i është thënë që do të kthehej sërish në vendin e njejtë.

Kjo pikë e versionit të S në mënyrë të qartë mohohet nga procesverbali i seancës me Gjykatësin Hetues.

Përkundër prej deklaratës së tij, është kërkuar nga ai që të japë më shumë sqarime.

Për më tej, në çastin e intervistimit, ai nuk ka mundur ta di që paraburgimi i tij do të zgjatej ngase vendimi i tillë do të merrej nga Gjykatësi Hetues vetëm pas përfundimit të deklaratës dhe pas kërkesës së prokurorit dhe mbrojtjes.

S nuk ka përmendur asnjë keqtrajtim të ushtruar nga ana e Policisë as në seancën për konfirmim të aktakuzës më 14 tetor 2004.

Pretendimet për keqtrajtimin nuk janë koherente, të dobëta ngase janë përplot me “nuk më kujtohet” apo “nuk e di” dhe pa ndonjë bashkëpunim.

Këto jo vetëm që mohohen nga zyrtarët e policisë, por edhe nga dokumentet, të gjitha nga të cilat përmbajnë nënshkrimet e të pandehurve dhe janë lexuar nga ai më parë.

E rëndësishme është që të vihet re që SHABANI jo vetëm lexoi, nënshkroi dhe në këtë mënyrë konfirmoi deklaratat e tij 22 mars, por edhe Raportin Hetues ku janë raportuar ca pjesë të deklaratave të tij.

Prandaj, pretendimet e të pandehurit duken si të pabaza.

Sa i përket zgjatjes së intervistës, kjo Gjykatë sheh si korrekte vlerësimin e Gjykatësit të Shkallës së Parë: përkthimi i të gjitha pyetjeve dhe përgjigjeve domosdoshmërisht merr ca kohë.

Zyrtarët e Policisë përmendën edhe një pushim gjatë intervistimit.

ishte atëherë 22 vjeç, një moshë që i lejon një intervistim prej katër orësh.

Ndërmjet intervistës së parë (që përfundoi në 16:45) dhe asaj të dytës (që filloi në 18:30) ishte një pushim prej një ore e 45 minutash.

Në këtë rast, nuk ka provë për “rraskapitje të krijuar” siç është përmendur në Nenin 155.1 nr. 1, KPPPK.

1.5 Ankesa e NR kujton kërkesën e mëparshme të mbrojtjes së tij për të veçuar deklaratat e dhëna nga Policia, kërkesë që është refuzuar nga Gjykata e Shkallës së Parë.

Ankesa nuk përmban gjë tjetër sa i përket kësaj pike.

Gjatë shqyrtimit kryesor, R në mënyrë narrative rrëfen që është frikësuar dhe kërcënuar nga Policia, që zyrtarët e Policisë URUQI dhe J i kishin larguar kopjet e tij, dhe që J i kishte detyruar të identifikojë të dyshuarit nga renditja për identifikim fotografik.



Sa i përket këtyre pretendimeve, vendimi i ankimuar merr në konsideratë pretendimet e të pandehurit, formularin mbi të drejtat e personit të arrestuar nga ^R dëshmitë e zyrtarëve të Policisë ^{BT, AV, JL} dhe deklaratat e të pandehurve para Gjykatësit Hetues dhe përfundon duke e refuzuar këtë pikë.

Kjo Gjykatë është e mendimit të njejtë sikurse Gjykatësi i Shkallës së Parë.

^R dy herë ka plotësuar formularin mbi të drejtat e e personit të arrestuar: hera e parë në çastin e arrestimit të tij më 5 prill, dhe i dyti para intervistës më 6 prill (dëshmitari ^T; seanca e 10 shkurtit 2005 dhe dy format).

Në që të dy formularët, pyetjet dhe përgjigjet ishin të njejtë.

Duhet të vihet re që nuk ka ndonjë kundërshtim ndërmjet përgjigjes në pyetjen nr. 7 të pjesës së parë ("a dëshironi të heqni dorë nga e drejta e juaj për të qëndruar në heshtje me ne tani?" përgjigja "PO") dhe përgjigja në pyetjen pasuese, atë nr. 4 të pjesës së dytë ("unë i kuptoj të drejtat e mia dhe tani dëshiroj të flas me Policinë" përgjigja "PO"):

^R dy herë ka shprehur vullnetin e tij për të biseduar me Policinë.

^R dy herë është përgjigjur me "Jo" në pyetje (nr. 8 të pjesës së parë dhe nr. 5 të asaj të dytë) nëse ka dashur të konsultojë avokatin mbrojtës.

Heqja e dorës është me shkrim dhe është nënshkruar nga i dyshuari si dhe nga autoriteti dëshmues.

Pyetja lidhur me dëshirën për të konsultuar avokatin dy herë është përgjigjur me JO, pas kësaj, në mënyrë eksplicite, i pandehuri ka deklaruar që është udhëzuar mbi të drejtat e tij dhe që i ka kuptuar këto të drejta.

Prandaj, kjo heqje dore është bërë në mënyrë të informuar dhe vullnetare dhe i përmbushë kërkesat e Nenit 69.3.

Në këtë pikë, nuk vërehet asnjë shkelje e të drejtave të të pandehurit.

- Sa i përket këpucëve që janë larguar nga Policia, pretendimet e ^R janë të pabaza për arsye të ndërlidhura me ato të dokumentimit dhe të deklaratave të tij dhe arsye logjike.

Nga teksti i deklaratave, del që pyetja lidhur me rrobat dhe këpucët që kishte veshur në ditën kritike është formuluar në fund të intervistimit.

Kjo konfirmon dëshmitë e zyrtarëve të Policisë, sipas të cilëve, këpucët janë zbatuar pas dhe jo gjatë intervistimit.

Duhet të konsiderohet që deklaratat janë marrë 20 ditë pas krimeve të hetuara, gjë që do të thotë që i pandehuri mund të ketë pasur kohën për të ndërruar (apo pastruar) rrobat si dhe këpucët.

Prandaj, duket që është e logjikshme dhe e nevojshme për të formuluar pyetje lidhur me rrobat para se të vendoset të sekuestrohen për shkaqe hetuese.


Këpucët nuk kanë mundur të sekuestrohen gjatë intervistimit, para se të jenë verifikuar nëse janë mbathur në ditën kritike.

Për më tej, siç duket nga procesverbali, pyetjet përkatëse janë formuluar vetëm në fund të intervistimit.

Për këto arsye, nuk mund të pranohen pretendimet lidhur me keqtrajtimit nëpërmjet sekuestrimit të këpucëve gjatë intervistimit.

- Pretendimet lidhur me keqtrajtimit dhe kërcënime nga ana e Policisë janë mohuar krejtësisht nga të gjithë zyrtarët e Policisë të përfshirë.

Këto pretendime janë formuluar për herë të parë gjatë shqyrtimit kryesor.



As para Gjykatësit Hetues më 7 prill 2004 e as para Gjykatësit Konfirmues më 14 tetor 2004, i pandehuri nuk ka përmendur keqtrajtimit nga policia gjatë intervistimit.

Gjatë shqyrtimit kryesor, R sqaroi që nuk ka përmendur Gjykatësit Hetues keqtrajtimit nga frika se do të kthehej në Polici dhe të rrahej.

Është ky një sqarim i ngjashëm me atë të S dhe as në këtë rast, nuk është bindës.

Në fakt, vendimi i Gjykatësit Hetues lidhur me gjendjen e paraburgimit të R është marrë pas intervistimit dhe pretendimet e keqtrajtimit nga ana e Policisë mund të kenë luajtur një rol të rëndësishëm në interesin e të pandehurit.

Moszbulimi i këtij fakti Gjykatësit Hetues bën që pretendimet e tilla gjatë shqyrtimit kryesor të jenë me vonesë dhe të pabesueshme.

- Gjatë shqyrtimit kryesor, (seanca e 1 shkurtot 2005) ka rezultuar që gjatë intervistimit të R nga policia, ky i pandehur është ballafaquar me I

Ky episod është rretyer nga dëshmitari zyrtar i policisë Ayni URUQI (seanca 1 shkurt 2005, faqe 53) si ballafaqim i shkurtër: A është marrë në pyetje ndërsa Policia ka sjellur R te dera e zyrës.

Zyrtarët e Policisë pyetën R nëse personi në zyrë A ishte i njejt i Agim me të cilin ishte gjatë trazirave, R i konfirmoi këtë dhe është larguar pa u futur në zyrë.

Dhuna apo kërcënimet nuk janë përdorur.

Në seancën e njejtë (faqja 34 dhe 53) A ka deklaruar që është rrahur me duart e një kolegu të U në praninë e këtij të fundit.

R (faqja 70) deklaroi që ka parë edhe JL si dhe AU duke dhënë shuplakë.

A, në të kundërtën, monoi që është rrahur nga U Në seancën e 29 marsit 2005, R refuzoi që është ndier i frikësuar gjatë këtij ballafaqimi nga sjellja e zyrtarëve U dhe L, të cilët rrahën R.

Në pyetjen se çfarë ka parë, I R deklaroi që W mori kokën e F me dotë derisa L qëndronte prapa.


R sqaroi që pa vetëm përkuljen e dhunshme të kokës së A nga ana e U (faqe 38).

I ballafaquar me pretendimin e shuplakës, bërë gjatë seancës së kaluar, R mohoi që ka përmendur shuplakën dhe shtoi që nuk i kujtohet.

Kjo pikë e pretendimit të R dhe A nuk është bindëse ngase kundërshtojnë njëri-tjetrin lidhur me URUQIN duke rrahur këtë të fundit, sepse R ka ndryshuar versionin e modalitetit të të rrahurit: dhënien e shuplakës apo në mënyrë të dhunshme përkuljen e kokës dhe për shkak se versioni i fundit të R (përkulja e dhunshme e kokës) e kundërshton atë të A sa i përket shuplakës.

Duhet të vihet re që para shqyrtimit kryesor, A asnjëherë nuk ka përmendur ndonjë dhunë, kërcënim apo rrahje nga ana e Policisë.

A gjithashtu pranoi që ka folur me R dhe I gjatë shqyrtimit lidhur me atë se çfarë kishte ngjarë në stacionin e Policisë (seanca e 22 mars 2005, faqe 42).



Mund të konkludohet që pretendimet e ^R në këtë pikë duken si të shpikura me qëllim që të mbështetin ato të ^A

- Pretendimet e ^R lidhur me sugjerimin që kshihte marrë nga zyrtarët e Policisë për identifikimin e një personi në renditje për identifikim fotografik i mungon mbështetja, përpos që mohohet nga dëshmitarët.

1.6 Ankesa e Agim ^A nuk përmban ndonjë koment sa i përket pranueshmërisë së deklaratave në Polici.

Kjo çështje duhet të sqarohet ex officio sipas Nenit 415.1, nënparagrafi 1 lidhur me Nenin 403.1, nënparagrafi 8, KPPPK.

Gjatë shqyrtimit kryesor, mbrojtja pretendoi që:

- është shkelur e drejta e të akuzuarit për të pasur përkthim në gjuhën që e kupton, pra në gjermanishte,

- që intervista në polici është bërë pa praninë e avokatit dhe që ka zgjatur mjaft, duke shkaktuar kështu rraskapitje të i pandehuri,

- që ^A është frikësuar dhe rrahur nga ana e Policisë.

Gjykata e Shkallës së Parë konsideroi dhe refuzoi të gjitha këto çështje (faqet 46-47) bazuar në sjelljen e të pandehurit gjatë shqyrtimit kryesor dhe nga provat që janë sjellë nga zyrtarët e Policisë dhe përkthyesit.

Kjo Gjykatë është e mendimit të njejtë sikurse Gjykatësi i Shkallës së Parë.

- Kuptimi i plotë i gjuhës shqipe nga ana e të pandehurit është konfirmuar nga dëshmitari dhe është observuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e Trupit Gjykses (seanca e 10 shkurtit 2005, faqe 44).

Për më tej, i pandehuri është përgjigjur plotësisht gjatë ekaminimit të tij të gjatë (seanca e 22 marsit 2005).

Nuk ekziston arsye për të dyshuar në korrektësinë e vlerësimit të bërë nga Gjykata e Qarkut në këtë pikë.


- Forma mbi të drejtat e personave të arrestuar në mënyrë të qartë deklaroi që ka hequr dorë nga e drejta e tij për të qëndruar në heshtje dhe ka pranuar të flasë me Policinë (përgjigja 7 e pjesës së parë dhe përgjigja 4 e pjesës së dytë) dhe që dy herë ka refuzuar të konsultohet me avokatin (përgjigja 8 e pjesës së parë dhe 5 e pjesës së dytë).

Edhe në këtë rast, hoqja dore nga e drejta e përmendur përmbushë kërkesat e Nenit 69.3, KPPPK për shkak se është me shkrim, e nënshkruar nga i dyshuari dhe nga autoriteti dëshmues, pyetja lidhur me dëshirën e të pandehurit për të konsultuar avokatin dy herë është përgjigjur me JO, pas kësaj i pandehuri i njejtë në mënyrë eksplicite ka deklaruar që është udhëzuar mbi të drejtat e tij në gjuhën e tij dhe që i ka kuptuar këto të drejta.

Prandaj, kjo heqje dore është bërë në mënyrë të informuar dhe vullnetare.

- Sa i përket keqtrajtimit, duhet të vihet re që ^A dy herë të parë ka pretenduar për to gjatë shqyrtimit kryesor, ndërsa nuk i ka përmendur para Gjykatës Hetues apo atij për Konfirmim.

Siç është vërejtur gjatë ekaminimit të pretendimeve të ^R ekzistojnë mospërputhje të mëdha ndërmjet deklaratave të fundit dhe atyre të lidhur me atë se çfarë ka ndodhur gjatë ballafaqimit në mes tyre.



A - as nuk ishte në gjendje të njohë Zyrtarin e Policisë L i personin që pretendon që e ka rrahur, duke thënë që është rrahur nga pas. Siç është vënë re më parë, A ka pranuar që ka folur me R dhe I gjatë seancave lidhur me atë që ka ndodhur në stacionin e Policisë. Pretendimet e tij nuk qëndrojnë, janë kundërshtuese, janë mohuar nga dëshmitarët dhe nuk mbështeten.

Siç është vënë re nga Gjykatësi i Shkallës së Parë, arsyet e dhëna nga i pandehuri lidhur me atë se pse nuk ka përmendur keqtrajtimin derisa është intervistuar nga Gjykatësi Hetues janë të përgjithshme dhe jo bindëse.

1.7 Ankesa e AI pretendon (sipas Neneve 153, 154 dhe 155, KPPPK) papranueshmërinë e provave të deklaratave të dhëna nga i pandehuri në Polici sepse:

- Zyrtarët e Policisë i kanë marrë syzet, të cilat i kishte pasur që nga shkolla fillore, kjo sjellje ishte në kundërshtim të Nenit 6, KEDN, dëmtoi aftësinë e të pandehurit që të lexojë deklaratën dhe i mundësoi Policisë të mbushë deklaratën me diçka që ky nuk e ka deklaruar,
- gjatë dhënies së deklaratave në Polici, zyrtarët kanë ushtruar presion psikologjik mbi të,
- Gjykatësit Hetues, i pandehuri i ka rrëfyer që i janë marrë syzet dhe nuk e ka njohur deklaratën e mëparshme si të tij,

Raporti i Policisë nuk përmban ndonjë datë sa i përket konfiskimit të ndonjë prone.

Gjatë shqyrtimit kryesor, mbrojtja gjithashtu ka pretenduar kërcënime dhe rrahje ushtruar ndaj të pandehurit në mënyrë që ky i fundit të detyrohet të nënshkruajë deklaratën në Polici. Për më tej, i është mohuar e drejta për avokat mbrojtës dhe familja e tij nuk është informuar për arrestimin e tij.

Gjykata e Shkallës së Parë konsideroi dhe refuzoi të gjitha këto çështje (faqet 45-46) bazuar në provat e dhëna nga Zyrtarët e Policisë, raporti nga Qendra e Paraburgimit lidhur me konfiskimin e gjësendeve personale, formularin mbi të drejtat e personit të arrestuar, raportin mjekësor në kushtet e tij.

Kjo Gjykatë nuk vëren ndonjë shkelje të dispozitave procedurale apo të konventave ndërkombëtare, të cialt do të mund të sjellnin deri te papranueshmëria e deklaratavë të dhëna nga i pandehuri në Polici.

- Forma mbi të drejtat e personit të arrestuar, është me shkrim dhe e nënshkruar nga i pandehuri dhe autoriteti dëshmuës.

Deklaron që I është përgjigjur me "PO" në dy pyetjet (nr. 7 e pjesës së parë dhe 4 të pjesës së dytë) lidhur me dëshirën e tij për të folur me Policinë dhe është përgjigjur me "JO" dy herë në dy pyetjet që kanë të bëjnë me dëshirën e tij për të konsultuar avoaktin dhe në mënyrë eksplicite ka deklaruar që është udhëzuar mbi të drejtat e tij në gjuhën e tij dhe që i ka kuptuar këto.

Prandaj, kjo heqje dore përmbushë kërkesat e Nenit 69.3, KPPPK.

Në formularin e njejtë, I është përgjigjur me "PO" në dy pyetjet që kanë të bëjnë me dëshirën e tij për të informuar familjen e tij (nr. 9 e pjesës së parë dhe nr. 3 e pjesës së dytë).



Pavarësisht kësaj, familja e tij nuk është informuar ngase në formularin e arrestit (faqe 509 e dosjes së Policisë) “nuk kishte qasje në rrjetin e telefonit”.

Siç është vërejtur edhe nga Gjykatësi i Shkallës së Parë, sipas Ligjit (Rregullorja e UNMIK-ut, 2001/28 dhe KPPPK) mungesa e informatave të menjëhershme për familjen e personit të arrestuar nuk ndikon në pranueshmërinë e deklaratave të dhëna në Polici.

Arsyetimi i Gjykatësit të Shkallës së Parë duket korrekt, duke pasur parasysh edhe pamundësinë materiale për të kontaktuar familjen e të pandehurit.

- Sa i përket marrjes së syzeve të të pandehurit, Memorandumi Ndërzzyrtar, i përpiluar nga Gjykata e Shkallës së Parë deklaron që **AI** është sjellë në qendrën e ndalimit më 7 prill 2004 në 19:10 dhe që të gjitha gjësendet personale të të pandehurit janë marrë nga ai atë ditë në orën 19:10.

Regjistri në Qendrën e Paraburgimit (faqe 1888 e dosjes së lëndës) përmban gjësendet e konfiskuara dhe në mesin e tyre janë edhe një palë syze, regjistri është nënshkruar nga i pandehuri.

Pasi që deklaratat në Polici atë ditë janë dhënë nga ora 15:30 deri 18:30, është e qartë që syzet e tijsi dhe gjësendet e tij të tjera akoma ishin në posedim të tij.

Zyrtarët e Policisë, të pranishëm gjatë marrjes së deklaratës nga **I** kanë konfirmuar që i pandehuri i ka mbajtur syzet e tij gjatë gjithë kohës **(T, L)** dhe që vetë e ka lexuar deklaratën e tij **U**.

Mund të shtohet që Gjykata e Shkallës së Parë ka vërtetuar aftësinë e tij për të parë dhe është konkluduar që kishte një miopi të thjeshtë **(**

Para Gjykatësit Hetues (faqe 11), në pyetjen se a i ka ndihmuar “ndonjë protestuesi atë ditë në përpjekje për të djegur një veturë të regjistruara serbe”, i pandehuri është përgjigjur si në vijim.

“Më duhet të ju sqaroj që nuk shoh mirë. Zakonisht kam ca probleme me syrin tim dhe atë ditë, as që i kisha syzet me vete. Tani në Qendrën e Paraburgimit, Policia nuk m'i lejon syzet. Kam kaluar, por asnjëherë nuk i kam ndihmuar apo asistuar ndonjë personi”.

Nga elementet e lartpërmendura, del që miopia e të pandehurit nuk ishte aq e madhe sa që ky të mos shkonte pa syze në Gjilan gjatë një dite të rrezikshme, siç ishte 17 marsi dhe të vërejë atë që i ka thënë Gjykatësit Hetues në mjaft detale.

Në shqyrtimin kryesor **I** tërhoqi deklaratën e tij, duke e përcaktuar si “gabim teknik” dhe tha se kishte mbajtur syzet gjatë gjithë ditës kritike.

Megjithatë kuptimi i fjalisë së cituar nuk le vend për asnjë lloj gabimi, qoftë ky teknik apo jo: ai ka mohuar të ketë ndihmuar këdo për të djegur një makinë sepse ai nuk shikonte mirë dhe nuk kishte vënë syzet.


Për këtë arsye, pretendimet e të pandehurit në këtë pikë nuk janë të bazuara në fakte sepse ata kundërshtohen nga dokumente dhe deklarata dhe nuk janë koherente me prova të tjera të dhëna nga ai.

- Në lidhje me keqtrajtimin dhe rrahjen.

Ai ka deklaruar se është goditur në kurriz nga **JL** i, i cili e ka shoqëruar në tualet gjatë dhënies së deklaratës së tij në polici.

Me ta ishte edhe një polic tjetër.

Goditja ishte “aq e fortë sa që nëse unë nuk do të kisha qenë përballë policit tjetër do të kisha goditur kokën në mur” (seanca e 15 shkurtit 2005 faqja 27).



Edhe pse grushti kishte qenë shumë i fortë i pandehuri nuk kishte ndonjë shenjë fizike të goditjes dhe raporti mjekësor mbi personin e arrestuar (faqja 1881 i dosjes së lëndës) deklaroi se ai është mjekuar për sinuse dhe dhimbje koke pa përmendur ndonjë shenjë rrahjeje.

Spjegimi i të pandehurit (ai nuk kishte shjenja pasi kishte veshur pallto dhe pulover pasi ishte fshehtë) nuk është koherent me dhunën e madhe që është përdorur mbi të siç pretendohet nga i pandehuri.

Ai nuk e ka përmendur rrahjen as të mjeku dhe as tek Gjyqtari Hetues apo të avokatët e tij.

Ai dha spjegim lidhur me këtë pikë (ai nuk kishte guxuar ta thoshte këtë tek doktori pasi nuk i dinte rregullat e parburgimit, të Gjyqtari Hetues kishte menduar se në gjyq do të silleshin njësoj si në polici, ai nuk i dinte rregullat dhe ka menduar se policia që ishte e pranishme në seancë do të sillej në të njëjtën mënyrë, ai nuk kishte biseduar me avokatët e tij pasi ata ishin çaktuar sipas detyrës zyrtare) dhe ky spjegim nuk është bindës.

Ai pretendon se i ka përmendur doktorit se kishte dhimbje në kurriz dhe se ai i kishte dhënë një injeksion.

Përkundrazi, siç është përmendur më lart, rezultoi se diagnoza kishte lidhje vetëm me sinuset dhe dhimbjen e kokës dhe nuk kishte lidhje me ndonjë dhimbje në kurriz.

Të Gjyqtari Hetues ai ka mohuar shumë të dhëna nga deklaratat e tij dhënë në polici pasi ai ka deklaruar se në atë rast kanë ndodhur shumë parregullsi.

Megjithatë ai nuk ka përmendur ndonjë lloj dhune apo keqtrajtim dhe për këtë arsye ato duhet të konsiderohen si pretendime të vonuara.

- I pretendon është keqtrajtuar dhe detyruar nga policia që të identifikojë fotografi të disa personave.

Sidoqoftë dhe pavarësisht këtij keqtrajtimi ai nuk ka njohur askënd dhe ky pretendim nuk është koherent.

Policitë të cilët ishin të pranishëm gjatë dhënies së deklaratës kanë mohuar çdo lloj keqtrajtimi apo dhune ndaj të pandehurit.

Pretendimet në lidhje me keqtrajtimet janë të pabazuara, kundërshtohen nga dëshmitarët si dhe nga dokumentacioni mjekësor dhe në vetvete nuk janë koherente.


1.8 Vërejtja e fundit ka të bëjë me besueshmërinë e deklaratës të të pandehurve dhënë në polici.

Është fakt i diktur se deklaratat e dhënë pak kohë pas ngjarjes janë në përgjithësi më të sakta, më të sinqerta, më të vërteta se deklaratat e dhëna më vonë, pas disa muajsh apo vjetësh.

Në përgjithësi në momentet e para dëshmitari apo i pandehuri nuk ka pasur akoma kohë që të përpunojë një version sipas interesave të tij.

Në këtë rast Gjykata e Shkallës së Parë (faqe 41) ka gjykuar si më të besueshme deklaratat e të pandehurve dhënë në fazat e hershme të procedurës sesa provat e tjera të mbledhura gjatë shqyrtimit kryesor, duke shtuar se asnjë nga personat e pranishëm është paraqitur për të ndihmuar në hetime edhe pse është bërë një apel publik nga policia dhe se edhe dëshmitarët okularë të paraqitur nga Prokurori nuk identifikuan kryerësit, ata "direkt apo indirekt janë shprehur se nuk kanë qenë në sallën e gjyqimit vullnetarisht".

Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është korrekt në këtë pikë.



Deklaratat e të pandehurve dhënë në polici konsiderohen nga KPPPK di prova të pranueshme dhe për këtë arsye ata mund të përdoren si bazë për një vendim apo dënim. Për më tepër besueshmëria e këtyre deklaratave është më e madhe pasi ato janë më të vërteta dhe nuk kanë ndikime nga burime të tjera.

Në këtë rast specifik versionet e paraqitura nga të pandehurit në polici janë të vërteta, pra të besueshme dhe të mjaftueshme për të dhënë një pasqyrë të asaj që ka ndodhur ato momente, ndërkohë që versione të ndryshme që ata kanë dhënë në shqyrtimin kryesor janë përpjekje për tu mbrojtur me qëllim që të parandalojnë çdo lloj dënimi.

2. Pika e dytë në lidhje me rregullat procedurale në lidhje me kohën e procedurës.

Në veçanti me kohën që ka kaluar nga shpallja e aktgjykimit dhe përpilimit dhe dorëzimi të vendimit është përcaktuar si e tepërt nga avokati mbrojtës! ^{NR} ^{dili} thekson se ky i pandehur ka qenë në paraburgim gjatë kohës që Trupi Gjykesor ka përdorur për të përgatitur vendimin me shkrim.

Në këtë rast, në bazë të Nenit 395.1 KPPPK vendimi duhet të ishte dhënë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga shpallja e tij.

Një vëmendje analoge mund të bëhet për ^{XJ} ^{si} cili ka qenë vazhdimisht në paraburgim që në datë 31 mars 2004, ndërkohë që apellantët e tjerë janë lënë në liri para shpalljes së vendimit të shkallës së parë.

Kjo lëndë ka një komplikim të veçantë: gjykata e shkallës së parë kishte të bënte me gjashtë të pandehur, çdo njëri prej tyre i akuzuar për vepra penale të veçanta, gjatë shqyrtimit kryesor janë dëgjuar tridhjetë e pesë dëshmitarë dhe janë zhvilluar njëzet e gjashtë seanca, për shkak të pjesëmarrjes së gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë gjithçka është përkthyer në anglisht dhe shqip, dosja e lëndës numëron mbi tre mijë faqe, vendimi me shkrim numëron pesëdhjetë e gjashtë faqe.

Është i pamohueshëm fakti se kjo lëndë komplekse kërkon kohë për të përfunduar shqyrtimin kryesor, për të marrë vendim dhe për të shkruar vendimin.

Vendimi i shkallës së parë u shpall më datë 19 maj 2005; vendimi me shkrim u dorëzua në Regjistrin e GjQ Gjilan UNMIK më datë 29 nëntor 2006.

Ankesa e fundit është paraqitur më datë 26 janar 2007; seanca ankimore nuk është caktuar para dorëzimit të lëndës EULEX-it më datë 30 janar 2009.

Kjo Gjykatë është e mendimit se koha e lartpërmendur ka qenë shumë e gjatë dhe nuk përkon me kohëzgjatjen e "arsyeshme" të procedurës siç parashihet nga konventat internacionale.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe legjislationit të Vendeve Anëtare të Këshillit të Evropës kohëzgjatja "e paarsyeshme" e procedurës mund të çojë deri në një formë kompensimi financiar.

Nuk është kompetencë e kësaj Gjykate që të marrë vendim në lidhje me një formë kompensimi financiar në bazë të zgjatjes së paarsyeshme të procedurës penale.

Megjithatë, dhe në rast të dënimit, kjo pikë mund të konsiderohet në bazë të dispozitës së Nenit 66 nr. 2 të KPPK si rrethanë lehtësuese⁷, e cila sodoqoftë duhet të krahasohet me rrethanat rënduese dhe peshën e veprës.

⁷ Në këtë kuptim shiko Gjykata e Qarkut Prishtine 9 nëntor 2007 ^{JM}
Prishtine 5 tetor 2007 B.M dhe Gjykata Supreme e Kosovës 10 prill 2009 ^{JK}



3. Si përfundim mund të vihet re se, në procedurën e Gjykatës së Shkallës së Parë nuk ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës penale siç parashihet nga Neni 403 paragrafi 1 nënparagrafi 1, 2, 6, 8, 9, 10, 11 KPPPK të cilin kjo Gjykatë duhet ta ekzaminojë sipas detyrës zyrtare.

Shkelja e paraparë nga neni 403 paragrafi 1 nënparagrafi 12 KPPPK duhet gjithashtu të ekzaminohet sipas detyrës zyrtare.

Kjo lloj shkeljeje është ngritur në detaj nga çdo ankesë dhe do të ekzaminohet për secilin të pandehur si në vijim.

Shqyrtimi kryesor nuk është zhvilluar në mungesë të të akuzuarve apo avokatëve të tyre mbrojtës.

Për këtë arsye nuk ka shkelje të parapara nga Neni 415 paragrafi 1 pikat 2 and 3 KPPPK.

4. Përsa i përket shkeljes se ligjit penal

Pika e parë paraqitet nga një konkurrencë e mundshme e dy veprave penale (si kryerja e një vrasje të rëndë nga njëra anë dhe pjesëmarrja në një grup i cili kryen vepra penale nga ana tjetër) të kryera në të njëjtin kontekst.

Ankesa e NR pretendon shkeljen e ligjit penale duke supozuar se “është e pamundur të kryhen dy vepra penale në të njëjtën kohë”, sipas ankesës Gjykata e Shkallës së Parë dështoi në detyrën e saj që të zoiidhte një nga veprat penale.

I njëjti problem mund të shihet në rastin e XS i cili ishte dënuar për dhënien e ndihmës në vrasje të rëndë dhe për pjesëmarrje në një grup që kryen vepra penale.

Kjo pikë nuk mund të pranohet.


Siç u pa më lart, Gjykata e Shkallës së Parë ka dënuar NR për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë dhe XS i për dhënie ndihme në kryerjen e vrasjes së rëndë në dëmtim të SP dhe të dy ata për pjesëmarrje në një grup që kryen një veprë penale, veprën penale të vrasjes së shëndime të rënda trupore AP dhe dëme të konsiderueshme shtëpisë dhe një makine të tyre. Apeli në emër të R nuk mund të përqendrohet në problem kur thotë se është e pamundur “të kryejë dy krime në të njëjtën kohë”, sepse është shumë e mundur në fakt të kryesh dy vepra penale të ndryshme me një sjellje të caktuar: dikush mund të mendojë vrasjen e një një personi dhe të shkaktojë plagosjen e një tjetri me të njëjtën mënyrë si p.sh. të eksplodojë një bombë.

Ajo që nuk është e pranueshme është rasti kur një i pandehur është dënuar për të njëjtin fakt në bazë të dy dispozitave të ndryshme ligjore, që do të thotë se ai është dënuar dy herë për të njëjtin fakt.

Në shikim të parë vërejtja e mbrojtjes mund të duket e arsyeshme kur pretendon se R dhe S janë dënuar pasi kanë vrarë (apo kanë ndihmuar në vrasjen) Slobodan Peric dhe në të njëjtën kohë për pjesëmarrjen e tyre në një grup i cili ka vrarë të njëjtin viktimë.

Përkundrazi mund të vihet re se Neni 200.1 LPK dënon “thjesht pjesëmarrjen në këtë lloj grupi, dhe fakti nëse i pandehuri kryen veprën penale i cili përfaqëson qëllimin e grupit nuk është i domosdoshëm.

Për më tepër në rastin konkret dënimi i të dy të pandehurve për veprën penale paraparë nga Neni 200.1 bazohet në pjesëmarrjen e tyre në një grup, përveç vrasjes së Slobodan



Peric, ka kryer vepra penale të tjera si dhe lëndimin e rëndë trupor të dhe demet e konsiderueshme të pronës së personave të tjerë.

Pjesëmarrja konkrete e dy të pandehurve në këtë grup trajtohet në pjesë të tjera të këtij aktgjykimi.

Arrijmë në përfundimin se ata nuk janë dënuar dy herë për të njëjtin fakt, sepse të dy nuk janë dënuar dy herë për të njëjtin fakt, sepse në rastin e tyre dispozita e Nenit 200.1 LPK aplikohet për aktivitetet e një grupi përveç vrasjes së S

5. Pika e dytë ka të bëjë me aplikimin e ligjit penale dhe duhet të ekzaminohet ex officio sipas Nenit 415, paragrafi 1, pika item 4 lidhur me Nenin 404 paragrafi 4, KPPPK.

Gjykata e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar për veprën penale vrasje e rëndë dispozitat ligjore të Neneve 146 dhe 147, pika 5, KPPK (lidhur me Nenin 23 për dhe Nenin 25 për i vend të dispozitës korrekte ligjore të Nenit 30, paragrafi 2 pika 5 të Ligjit Penal të Kosovës (lidhur me Nenet e Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë 22 për dhe 24 për

Çështja e ligjit të aplikueshëm fillimisht duhet të zgjidhet nëpërmjet zbatimit të ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale: në këtë kuptim, Neni 2 paragrafi 1 KPPK dhe Neni 4 paragrafi 1 KP RSFJ.

Që të dy dispozitat ligjore të lartpërmendura në rastin e ndryshimit të ligjit penal në kohën ndërmjet faktit dhe vendimit përfundimtar në të, në këtë rast më i favorshmi (apo më pak i rëndë) i ligjit do të zbatohet (shihni Nenin 2, paragrafi 2 KPPK dhe Neni 4 paragrafi 2 KP RSFJ).

Në këtë lëndë, krimi i pretenduar i vrasjes së rëndë është kryer më 17 mars 2004, para se KPPK-ja të futet në fuqi dhe LPK dhe dispozitat e saj të jenë në efekt.

Gjykata e Shkallës së Parë ekzaminon këtë çështje (faqet 51 dhe 52) dhe mori vendimin që të zbatohet ligjin e ri (Neni 146 dhe 147 lidhur me Nenin 23) ngase është besuar të jetë më i favorshëm për të pandehurin.

Kjo Gjykatë është e mendimit që ligji i vjetër (Neni 30 paragrafi 2 pika 5, LPK) është i zbatueshëm për shkak se i riu nuk është më i favorshëm për të pandehurin.

Sipas dispozitave ligjore të LPK-së, fakti është i dënueshëm me burgim prej dhjetë deru në katërdhjetë vite.

Është një lloj dënimi unik (burgimi) për shkak se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/59, pjesa 1.6 zëvendësoi dënimin me vdekje, në paraparë fillimisht nga LPK, me burgimin deri në maksimumin prej katërdhjetë vitesh.

Sipas Nenit 38, KP RSFJ, personi i dënuar me dënimin me burgim mund të përfitojë nga lirimi me kusht pas shërbimit të gjysmës së dënimit.

Neni 147 i KPPK përcakton dy lloje të ndryshme dënimesh: burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet (lexoni Nenin 147 së bashku me Nenin 38, Paragrafi 1 të KPPK) dhe burgim afatgjatë nga njëzet e një vjet deri në dyzet vjet (shihni Nenin 37, Paragrafi 2 të KPPK).



Duhet të kihet parasysh se burgimi afatgjatë është më pak i favorshëm se burgimi i paraparë me anë të Nenit 30 KPK, edhe pse gjatësia maksimale është e njëjtë.

Kjo ndodh për dy arsye: minimumi i burgimit afatgjatë (njëzet vjet) është më i lartë se minimumi i burgimit (dhjetë vjet); personi që dënohet me burgim afatgjatë mund të përfitojë lirinë me kusht vetëm pasi ka kryer tri të katërtat e dënimit të tij, në vend të gjysmës.

Në bazë të ligjit të ri, gjyqtari ka mundësinë të zgjedhë mes burgimit dhe burgimit afatgjatë; kjo do të thotë se ai ka mundësinë të aplikojë një dënim (burgim afatgjatë) që është më pak i favorshëm se ai dënim që parashikohet me anë të ligjit të vjetër.

Për këto arsye, në rastin e një dënimi të të pandehurve, duhet të gjejë aplikim Neni 30, Paragrafi 2, Pika 5 e Kodit Penal të Kosovës.

Nuk mund të vihen re ndryshime themelore mes Nenit 22 të KP RSFJ dhe Nenit 23 të KPPK.

Së fundmi, mund të vihet re se gjyqtari i parë e ka aplikuar saktësisht Nenin 200, Paragrafin 1 të KPK, si ligjin në fuqi në momentin kur ka ndodhur ngjarja, në vend të Nenit 320 të KPPK, sepse këto dy dispozita ligjore janë identike përsa i përket termave të dënimit.

II

Ankesa e z. Mustafë MUSA, ai avokat mbrojtës i të pandehurit  është dorëzuar më 26 janar 2007.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë kundërshtohet në lidhje me:


- shkeljeve themelore të procedurës penale, veçanërisht të Neneve 403, Paragrafi 1, Pika 12, lidhur me Nenet 153, 154, Paragrafët 4 dhe 5, Nenin 155, Paragrafi 1 dhe Nenin 157 KPPK,
- verifikimit të gabuar dhe të paplotë të gjendjes faktike,
- shkeljeve të ligjit substancial,
- vendimin në lidhje me dënimin.

Avokati mbrojtës propozon:

- të modifikohet aktgjykimi dhe të lirohet i akuzuari nga përgjegjësia penale, ose
- të shpallet një dënim më i butë, ose
- të hidhet poshtë aktgjykimi dhe çështja të dërgohet për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Bazat e ankesës janë si më poshtë vijon:

1. Shkelje themelore të procedurës penale, si:



- dispozitivit i mungon dhënia e përshkrimit të përgjithshëm të veprimeve inkriminuese të të pandehurit,
- kontradiktave të aluduara mes dispozitivit dhe arsyetimit,
- mungesa e prezantimit të arsyeve të drejta në lidhje me faktet vendimtare,
- dispozitivi është i pakuptueshëm, sepse është vështirë të ekzekutohet,
- shkelje të të drejtave të të pandehurit gjatë deklaratës së tij dhënë në polici, më 22 mars 2004, deklaratë kjo e cila duhet të ishte ndarë nga dosja e lëndës, dhe mbi të cilën të mos bazohej aktgjykimi i Gjykatës,
- shkelje e Nenit 157 KPPPK në kuptimin që dënimi i të pandehurit është bazuar mbi një deklaratë të vetme.

Kjo bazë e ankesës është subjekt i mendimit të mëposhtëm të kësaj Gjykate:

a) Dispozitivit i mungon dhënia e përshkrimit të përgjithshëm të veprimeve inkriminuese të të pandehurit.

Duhet të vihet re se shkeljet themelore të procedurës penale të parapara me anë të Nenit 403, Paragrafi 1, Pika 12 të KPPPK në lidhje me dispozitivin kanë lidhje me qartësimin e tij, qëndrueshmërinë e brendshme të tij dhe qëndrueshmërinë lidhur me bazat për aktgjykimin.

Ligji nuk kërkon që dispozitivi të përmbajë një përshkrim shumë të detajuar të sjelljes së personit të dënuar, sepse përshkrim është një çështje e arsyetimit të aktgjykimit.

Megjithatë, dispozitivi duhet të jetë “i kuptueshëm”, që do të thotë se ai duhet të bëjë të qartë se çfarë ka bërë i pandehuri.

Në rast se, si në këtë çështje, dispozitivi në lidhje me sjelljen e më shumë të pandehurve të cilët veprojnë pjesërisht së bashku, duhet të lexohet tërësisht sepse konteksti i përgjithshëm mund të japë disa tregues lidhur me sjelljen e një pjesëmarrësi të vetëm.

Përshkrimi i sjelljes lidhur me këtë dhe të pandehur të tjerë, që është dhënë në dispozitiv është shumë i qartë dhe i kuptueshëm.

Më 17 mars në Gjilan ka pasur një turmë të madhe të inatosur njerëzish, e cila duke vepruar në mënyrë të pamëshirshme dhe të dhunshme “ka sulmuar” Sllobodan dhe Anka Periçin dhe pronën e tyre.

Sulmi është përshkruar me anë të referencës që i bëhet një turme e cila ka ndjekur, rrethuar dhe goditur me shkopinj dhe gurë Sllobodan Periçin.

Disa persona (R dhe të tjerët) kanë vepruar drejtëpërdrejtë kundër S dhe i morën jetën, disa të tjerë S në ndihmë në këtë gjë. SP

Të tjerët, mes tyre edhe S kanë marrë pjesë në një turmë të inatosur e cila ka sulmuar viktimat dhe pronat e tyre, duke marrë jetën e një burri, duke lënduar rëndë një grua dhe duke dëmtuar në mënyrë të vazhdueshme shtëpinë dhe një makinë të tyre.

Shihet qartë nga dispozitivi, se përsa i përket S ka qenë prezent dhe ka marrë pjesë në mënyrë të vullnetshme me të tjerët në këtë sulm të dhunshëm, i cili rezultoi në vdekjen e një personi, lëndimin dhe dëmet e përshkruara më sipër.

b) Kontradiktat e aluduara mes dispozitivit dhe arsyetimit:

Ankesa nuk qartëson kontradikatat e aluduara mes dispozitivit dhe arsyetimit.



Aktgjykimi i kundërshtuar shpjegon (në faqen 50) arsyet për dënimin e këtij të pandehuri: "Gjykata është e mendimit se akti i hedhjes së gurëve drejt shtëpisë së Periçëve përbën të gjithë elementët objektivë dhe subjektivë të veprës penale" që është parashikuar me anë të Nenit 200.1 të KPK, duke pasuar me përshkrimin e sjelljes së grupit dhe rezultatet e kësaj sjelljeje.

Kjo pjesë e arsyetimit është plotësisht në përputhje me dispozitivin në lidhje me pozitën që i rezervohet

Prandaj, kjo pjesë e ankesës nuk është e bazuar.

c) Mungesa e prezantimit të arsyeve të drejta në lidhje me faktet vendimtare:

Po ashtu, edhe kjo pjesë e ankesës është e pabazuar.

Këtu mund të shihen konsiderata të ngjashme me ato të çështjes paraardhëse: ankesa nuk specifikon se përse arsyet e paraqitura në aktgjykim nuk duhet të jenë "të drejta".

Duke pasur parasysh kontekstin e fakteve të asaj dite, kontekst ky i cili është përshkruar me hollësi dhe më shumë se një herë nga gjyqtari i parë, aktgjykimi tregon sjelljen e këtij të pandehuri si pjesëmarrës i një turme të madhe të inatosur, e cila ka sulmuar viktimat dhe pronat e tyre.

Kontributi i tij i veçantë është vënë re në hedhjen e gurëve drejt shtëpisë së viktimës (sipas deklaratës së [S] dhe kundër viktimës [SP] [P] (sipas deklaratës së [S] dhënë përpara Policisë).

Prandaj, pjesëmarrja e tij ka qenë aktive, materiale, e dhunshme dhe e qëllimshme; rezultatet e veprimeve të tij të drejtëpërdrejta ishin një dëmtim i mundshëm i pronës dhe viktimës dhe një inkurajim jo i drejtëpërdrejtë dhënë të tjerëve për vepra të tjera penale.

Fakte të tjera vendimtare, si alibia e të pandehurit dhe rezultatet e kriminalistikës e të ekzaminimit të ADN-së, do të shqyrtohen në paragrafin tjetër.

d) dispozitivi është i pakuptueshëm, sepse është vështirë të ekzekutohet

Kjo çështje nuk është e bazuar.

Dispozitivi e tregon qartësisht veprën penale për të cilën ka edhe një dënim (Neni 200.1 KPK), dënimi (2 vjet e 6 muaj burgim), koha e shpenzuar në paraburgim (nga 22 marsi 2004 deri më 4 shkurt 2005) e cila duhet të përfshihet në sasinë e dënimit, dhe detyrimin e të gjithë të pandehurve që bashkërisht duhet të riimburojnë shpenzimet.

Mbi këtë bazë nuk ka gjëra të paqarta në dispozitiv, të cilat mund të bëjnë atë "të vështirë për t'u ekzekutuar".

e) Shkelje të të drejtave të të pandehurit gjatë deklaratës së tij dhënë në polici, më 22 mars 2004, deklaratë kjo e cila duhet të ishte ndarë nga dosja e lëndës, dhe mbi të cilën të mos bazohej aktgjykimi i Gjykatës,

Kjo çështje është marrë tashmë në shqyrtim më sipër dhe është gjykuar si e pabazuar (shihni pikën I.1.4).

f) Shkelje e Nenit 157 KPPPK në kuptimin që dënimi i të pandehurit është bazuar mbi një deklaratë të vetme.



Neni 157.2 i KPPPK nuk e lejon gjykatën ta shpallë të akuzuarin fajtor “duke u bazuar vetëm në, apo deri në një farë mase të konsiderueshme, në deklaratat që janë dhënë nga i pandehuri në polici apo përpara prokurorit publik”.

Kjo do të thotë që dënimi nuk mund të bazohet mbi një deklaratë të vetme dhënë nga i pandehuri jo përpara një gjykatësi.

Pavarësisht nga kjo, në këtë rast, burimet e provave kundër [S] janë tri deklaratat të ndryshme, dy prej të cilave të dhëna nga [AA] të Polici dhe përpara Gjykatësit Hetues, dhe një deklaratë e dhënë nga vetë Sadr SHABANI në Polici.

Në të dyja deklaratat e tij, [A] i kujtohet ta ketë parë [S] të cilin ai e ka njohur në fotografitë që i janë treguar atij nga Policia) përpara shtëpisë së qytetarit serb, duke hedhur gurë në drejtim të saj.

Vetë [S] ka pranuar të ketë hedhur gurë në drejtim të së njëjtës shtëpi si edhe në drejtim të burrit serb, kur ai doli jashtë dhe filloi të ecte poshtë në drejtim të rrugës.

Prandaj, dispozitat e Nenit 157.2 të KPPPK nuk gjejnë aplikim këtu dhe kjo çështje e ankesës është e pabazuar.

2. Verifikimit të gabuar dhe të paplotë të gjendjes faktike, si – alibia e të pandehurit nuk është marrë saktësisht në konsideratë nga gjyqtari i parë,

- nuk janë paraqitur prova materiale kundër tij, meqë të dyja ekzaminimet, si ato kriminalistike ashtu edhe ato të ADN-së kanë pasur rezultate negative,

- deklaratat e dhëna nga [AA] përpara Policisë ashtu edhe përpara Gjyqtarit Hetues, të cilat e akuzojnë [S], kanë qenë trillime, ashtu siç ka deklaruar [A] në gjykimin kryesor.

Kjo bazë e ankesës zhvillohet më tej duke u bazuar në çështjet e mëposhtme.

a) Alibia e të pandehurit nuk është marrë saktësisht në konsideratë nga gjykatësi i parë. Sipas mbrojtjes, [S] e ka kaluar të gjithë kohën në lagjen e tij, përveç një vizite të shkurtër në një farmaci në qytet ku ka shkuar për një fqinjin e tij, kohë kjo gjatë së cilës nuk ka pasur turbullira.

Vetëm më vonë dhe përsëri në lagjen e tij, i pandehuri dhe disa banorë të tjerë u desh të përballëshin me një sulm të dhunshëm nga disa njerëz të cilët u larguan.

Aktgjykimi i kundërshtuar shqyrton alibinë e të pandehurit në tri pika, duke dhënë një pasqyrë të dëshmimeve të dëshmitarëve të mbrojtjes, (faqet 33 dhe 34), të deklaratës së të pandehurit dhënë në gjykimin kryesor (faqet 39 dhe 40) si edhe të vlerësimit të përgjithshëm të provave lidhur me të (faqja 50).

Arsyetimi i gjyqtarit të parë duket se nuk përmban elementë të pallogjikshëm, duke shpjeguar se deklaratat e dëshmitarëve të mbrojtjes nuk e mbulojnë kohën e faktit dhe se tregimet e tyre ndodhin përpara sulmit ndaj [S].

Faktikisht dëshmitarët e mbrojtjes flasin për episode të veçanta, që kanë zgjatur disa minuta dhe që kanë ndodhur mes orës 3 dhe 5 pasditë.

Fakti kundër [S] është vendosur nga dëshmitari N.B. pas orës 5



Dëshmitarët e Policisë kanë arritur në vend edhe më vonë se kjo orë (Bekim Zeneli thotë se ai ka marrë një telefonatë në orën 18:20, Jakup Xheladini kujton se njësia e urgjencës arriti pas orës 20:00).

Duhet shtuar gjithashtu se sipas deklaratave të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mbrojtës vendi i ngjarjes (shtëpia e SP dhe vendi ku aludohet të ketë qenë në shtëpinë në lagjen e tij) gjenden shumë pranë njëri-tjetrit. S ka treguar lidhur me 2/3 minuta që ka ecur nga shtëpia e tij deri në Gjykatë, duke u kthyer përmes parkut.

Duhet kujtuar se shtëpia e Periçit gjendej afër parkut.

NA t ka deklaruar se shtëpia e SP ishte 300 metra larg shtëpisë se tij që gjendej në ndërtesën e shkollës, ai mund të dëgjonte zhurmat që vinin nga turma; ai e ka parë S tërdisa sekonda rreth orës 3.30 pasdite përpara shkollës.

Shtëpia e S D gjendet 10 metra larg asaj së S e afër shtëpisë së SP

Së fundmi, alibia e S kundërshtohet nga vetë deklaratat e tij dhënë në polici, ku ai ka pranuar të ketë qenë prezent në turmë duke hedhur gurë në drejtim të shtëpisë së viktimave.

b) Nuk janë paraqitur prova materiale kundër tij, meqë të dyja ekzaminimet, si ai i kriminalistikës ashtu edhe ai i ADN-së kanë rezultuar negative.

Aktgjykimi i kundërshtuar shqyrton rezultatet e ekzaminimeve kriminalistike në faqen 40.

Kjo Gjykatë është e mendimit se rezultatet e ekzaminimeve të ADN-së nuk e përjashtojnë përgjegjësinë e të pandehurit, siç bazohet ajo mbi prova të tjera.

Faktikisht, ashtu siç del edhe nga Raporti Hetimor i datës 22 mars 2004, rrobat e S f janë sekuestruar në të njëjtën datë, 22 mars, pasi hetuesve u është thënë nga i pandehuri se ai kishte veshur të njëjtat rroba që kishte veshur edhe më herët, më datën 17.

Që rrobat e sekuestruara nga i pandehuri janë të njëjta me ato që ai kishte veshur në ditën kritike, kjo përbën vetëm një supozim të tij, i cili mund të mos jetë i vërtetë.


Edhe pse rrobat janë të njëjta, ndërkohë atom und të ishin larë dhe gjurmët eventuale mund të jenë hequr.

Për këto arsye rezultatet negative të ADN-së dhe ekzaminimet kriminalistike të rrobave të të pandehurit nuk janë vendimtare në këtë çështje.

c) Deklarat e dhëna nga AA, si përpara Policisë ashtu edhe përpara Gjyqtarit Hetues, të cilat e akuzojnë B, kanë qenë trillime, meqë A e ka deklaruar këtë në gjykimin kryesor.

Kjo çështje është shqyrtuar tashmë më sipër (shihni pikën I.1.6) dhe është konsideruar si e pabazuar.

3. Shkelje të ligjit substancial, si:



- aplikim i gabuar i Nenit 200, Paragrafi 1 të KPK lidhur me elementin e kërkuar subjektiv,
- shkelje të Nenit 23 të KPPK lidhur me veprimet e ndërmarra nga i pandehuri dhe lidhur me elementin e kërkuar subjektiv të përcaktuar nga dispozita ligjore.

Bazat e ankesë zhvillohen lidhur me çështjet e mëposhtme:

a) Vepra penale e përcaktuar me anë të Nenit 200.1 të KPK kërkon pasjen e qëllimit “që do të thotë ndërgjegjshmërinë e kryesit të veprë penale që të jetë në një grup, i cili me anë të veprimeve të përbashkëta kryen vepra penale”.

Asnjë provë nuk mund ta konfirmonte këtë qëllim lidhur me § 33

Kjo Gjykatë ndan mendimin se vepra penale e paraparë me anë të Nenit 200 është “e qëllimshme” që do të thotë të jesh i ndërgjegjshëm për veprimin dhe pasojat e tij dhe të dëshirosh kryerjen e veprës (Neni 15.2 KPPK) ose të paktën të pranosh pasojën e saj të ndaluar (Neni 15.3 KPPK).

Provat në dosjen e çështjes janë të qarta në kuptimin që § ishte mjaft i ndërgjegjshëm që turma po hidhte gurë në drejtim të shtëpisë dhe personit të Sllobodan Periçit: ai ka deklaruar përpara policisë t’i jetë bashkuar një grupi protestuesish dhe së bashku me ta të ketë hedhur gurë në drejtim të shtëpisë së viktimës dhe vetë viktimës.

Këto sjellje janë qartësisht të qëllimshme, të kryera nga ndërgjegjja dhe vullneti i nevojshëm.

Nuk është e nevojshme të planifikosh e të organizosh paraprakisht (për të paramenduar) një vepër penale me qëllim që të keshë qëllimin, sepse vendimi mund të merret nga ana e kryesit të veprës penale edhe në momentin e kryerjes së vetë veprës.

b) Bashkëpunimi i paraparë me anë të Nenit 23 të KPPK kërkon ndarjen e punëve mes pjesëmarrësve, qëllimin e tyre të përbashkët për të kryer veprën penale, nevojën që secili pjesëmarrës është vendim-marrës në kryerjen e krimit. Ankesa vë në pah mungesën e provave lidhur me rolin, veprimet, vendimet dhe dëshirën e të pandehurit përsa i përket bashkëpunimit të tij në veprën penale.

Kjo Gjykatë e konsideron këtë çështje sit ë pabazuar, për të njëjtat arsye të cilat janë shqyrtuar në çështjen e mësipërme.


Vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, nuk kërkon një plan paraprak dhe as një organizim preçiz.

Këtu ndëshkohet një grup njerëzish të cilët formojnë, po ashtu në mënyrë spontane, dhe vendosin, po ashtu papritur, të kryejnë një vepër penale.

Nuk ka nevojë që të ketë një marrëveshje të veçantë, të shprehur mes pjesëmarrësve lidhur me vendimin, rolet dhe qëllimet e veprimeve, sepse kjo vepër penale është kryer kur marrëveshja mes bashkëkryesve është e heshtur dhe është bërë përmes sjelljes materiale (facta concludentia).

SHABANI ka pranuar të ketë parë një turmë të inatosur, të ketë kuptuar që ajo po sulmonte shtëpinë dhe viktimën dhe të ketë marrë pjesë në të, duke dhënë kontributin e tij material dhe duke hedhur gurë.

Kjo gjë i përmbush kërkesat e Nenit 23 të KPPK.



4. Vendimin në lidhje me dënimin, si:

- rëndesën ekstreme të dënimit.

Në këtë çështje ankesa thotë se nuk i është dhënë konsideratë e mjaftueshme nga gjykatësi i parë moshës së re, mungesës së rekordit penale dhe sjelljes korrekte të të pandehurit në gjykatë, dhe avokati përmes ankesës kërkon një dënim më të butë.

Gjyakata e shkallës së parë i ka marrë në konsideratë si rrethanat rënduese ashtu edhe ato lehtësuese të kësaj çështjeje.

Sipas Nenit 64.1 KPPPK dënimi do të përcaktohet duke i marrë në konsideratë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe dënimi do të jetë në përputhje me rëndesën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit të veprës penale.

Kjo Gjykatë e ndan mendimin e gjykatësit të parë lidhur me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, e veçanërisht motivet e rrezikshme, rrethanat e veçanta të veprës dhe mënyrën brutale të kryerjes së veprës si rrethanë rënduese.

Këtij të pandehuri mund t'i atribuohet rrethana lehtësuese e treguar në ankesë, dhe rrethana lehtësuese lidhet me kohën e madhe që ka kaluar në dorëzimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Megjithatë, rëndesa e veprës penale dhe motivet që lidhen me urrejtjen ndaj një etnie tjetër, duket se janë kaq të larta, saqë ato e parandalojnë çdo rrethanë lehtësuese.

5. Duke i marrë në konsideratë të gjitha këto, Gjyakata e Shkallës së Dytë vendos ta refuzojë ankesën e dorëzuar në emër të të pandehurit ! *NS*

III

Ankesa e z. Arben MUSTAFA si avokat mbrojtës i të pandehurit i *NR* është dorëzuar më datën 12 dhjetor 2006.

Aktgjykimi i shkallës së parë kundërshtohet në lidhje me:

- shkeljeve themelore të procedurës penale, veçanërisht të Nenit 403, Paragrafi 1, Pika 12 e KPPPK,
- shkeljeve të ligjit penal, Neni 404 i KPPPK
- verifikimit të gabuar dhe të paplotë të gjendjes faktike, Neni 406 i KPPPK
- vendimin në lidhje me dënimin, Neni 406 i KPPPK.

Avokati mbrojtës propozon:

- të hidhet poshtë aktgjykimi dhe çështja të dërgohet për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- të modifikohet aktgjykimi në lidhje me paditë.

Bazat e ankesës janë si më poshtë vijon:



1. Shkelje themelore të procedurës penale.

Kjo bazë e ankesës zhvillohet lidhur me çështjet e mëposhtme:

- aludohet se aktgjykimi është i paqartë, i ngatërruar dhe në kundërshtim me veten e tij dhe arsyet e dhëna,
- mungesën e arsyeve bindëse në lidhje me faktet vendimtare,
- kontradikta të konsiderueshme mes arsyeve të dhëna dhe provave të shqyrtuara të marra gjatë gjykimit kryesor,
- Gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale, kur ajo nuk ka ndarë deklaratat e dhëna nga i pandehuri në Polici, pavarësisht nga fakti që këto deklaratat janë kundërshtuar nga vetë deklaratat e dhëna nga ata gjatë shqyrtimit kryesor,
- koha që është dashur për të dorëzuar tek palët aktgjykimin e shkruar, konsiderohet të jetë tepër e gjatë,
- Gjykata asnjëherë nuk i ka dorëzuar mbrojtjes dokumentet e përkthyer, të cilat mund të kenë pasur një farë peshe në lidhje me cilësinë e mbrojtjes.

Kjo Gjykatë nuk e ndan mendimin lidhur me këto çështje që ngrihen nga ankuesi.

- Çështja lidhur me ndarjen e deklaratave të Policisë, si prova të papranueshme është shqyrtuar dhe është refuzuar më sipër (shihni pikën **I.1.5**).

Këtu mund të shtohet se kontradiktat mes deklaratave të dhëna nga i njëjti person apo nga persona të ndryshëm, gjatë fazave të ndryshme të procedurës, është objekt i vlerësimit së meritave të çështjes (shihni më tej pikën **III.2**) dhe ato nuk kanë lidhje me pranueshmërinë e provave.

- Siç është vënë re edhe më sipër (shihni pikën **II.1**) ligji nuk kërkon që dispozitivi të përmbajë një përshkrim shumë të detajuar të sjelljes së personave të dënuar, megjithatë ai duhet të jetë “i kuptueshëm”, dhe kjo do të thotë që duhet bërë e qartë se çfarë ka bërë i pandehuri.

Në këtë rast, dispozitivi duket se është mjaft i qartë në lidhje me sjelljen e secilit të pandehur, duke përfshirë edhe sjelljen e

Në fakt, ai shpjegon se më 17 mars ka pasur një turmë të madhe të inatosur, e cila ka sulmuar nënën e tij dhe pronën e tij në Gjilan.

Në këto rrethana, i pandehuri duke vepruar egërsisht dhe në mënyrë të dhunshme, ka shkaktuar vdekjen e

Pas sulmit mbi pronën dhe turma e inatosur e kanë ndjekur e ka goditur viktimën dy herë me një shkop, një herë në duar dhe një herë në kokë, dhe pastaj ka hipur mbi trupin e viktimës.


Kjo sjellje dhe ajo e bashkëkryesve të tjerë, të cilët e kanë sulmuar me shkopinj dhe gurë, e ka privuar viktimën nga jeta e tij.

Dispozitivi shton përkufizimin ligjor të sjelljes së përshkruar faktike të të pandehurve dhe kryesve të tjerë të veprës penale.

Prandaj dispozitivi përmban të gjitha elementët e kërkuar me anë të ligjit dhe nuk ka kontradikta në vete.

- Sa për mungesën e aluduar të arsyeve bindëse në lidhje me faktet vendimtare, pjesa arsyetuese shqyrton deklaratat dhe mbrojtjen e

Deklaratat e tij përballen me ato të dëshmitarëve të prokurorisë, si të tjerët.



Deklaratat e tij të dhëna gjatë shqyrtimit kryesor shqyrtohen (faqja 38) në vëçanti lidhur me qëndrueshmërinë e tyre.

Gjykata e Shkallës së Parë e shqyrton çështjen e pranueshmërisë së deklaratavë të tij të dhëna në Polici (faqet 44 dhe 45).

Së fundmi, (faqet 47 dhe 48) shqyrtojnë bazat për dënimin e këtij të pandehuri.

Të gjitha elementet e dhëna në aktgjykimin e kundërshtuar duket se janë koherente me njëra-tjetrën, bindëse dhe që çojnë në të njëjtin përfundim të dispozitivit.

- Provat mbi të cilat Gjykata e Qarkut e ka mbështetur gjykimin e saj lidhur me INR janë qartësisht të treguara në pjesën e arsyetimit të këtij aktgjykimi pa kontradikta.

Pasi Gjykata shpjegon se cilat prova kualifikohen si të pranueshme dhe arsyen e dhënë për një zgjedhje të tillë (këto janë deklaratat e të pandehurve në Polici, shihni faqen 41), ajo (Gjykata) ka vazhduar qëndrueshmërisht këtë zgjedhje.

Bazat në lidhje me dënimin e I R enden në deklaratat e dhëna në Polici nga

AI.
AI

XJ dhe AA
sujton:

- se ai së bashku me shokët e tij I R dhe A kanë ndihmuar njerëzit e tjerë të digjinin një makinë me targa serbe,
- se që të tre u janë bashkuar protestuesve dhe kanë hedhur gurë drejt shtëpisë së viktimës serbe,
- se në momentin që viktima ka dalë nga shtëpia me një armë dhe është drejtuar nga qendra, I R e ka ndjekur atë "me shkop në dorë", gjithashtu edhe I R kanë ndjekur viktimën,
- se me shkopin e tij R e ka goditur serbin në duar, kështu që arma dhe po ashtu edhe viktima kanë rënë përtokë,
- se Xheladini e ka hequr armën automatike,
- se më pas e gjitha kjo "u kthye në një rrëmujë" sepse turma e ka goditur serbin me gurë dhe shkopinj të drunjtë.

XJ


sujton:

- se ai e ka parë burrin serbtë ecte drejt qendrës duke mbajtur një Kallashnikov,
- se serbi po luftonte kundër një burri të moshuar që kishte në duar një tullë dhe se afër tij R e mbante në duar një shkop të drunjtë,
- se që të dy, ai burri i moshuar ashtu edhe R e kanë goditur serbin në kokë, i pari me tullë dhe i dyti me shkop,
- se burri i moshuar e hoqi armën,
- se disa individë, në mes të të cilëve ai njohu I R e trahën viktimën.

AA

sujton:

- se ai, R dhe I u bashkuan njerëzve që hidhnin gurë drejt shtëpisë së viktimës,
- se kur serbi doli nga shtëpia e tij duke mbajtur në dorë një armë, I R që kishte në duar një shkop, i shkoi "shumë afër",
- se njerëz të tjerë e ndoqën serbin, e se në mes tyre ishte edhe një burrë i moshuar,
- se serbi u godit në kokë nga një shkop i drunjtë dhe ra përtokë,
- se R është hedhur me dy këmbët e tij mbi trupin e serbit.



- se turma e ka goditur viktimën me gurë dhe shkopinj,
- se disa minuta më vonë *R* ka thënë atij "Ia kam qirë nënën (e tij serbe), e kam goditur atë 2 herë me shkop druri".

Gjyaktësi i parë e ka raportuar saktësisht dhe në një mënyrë të logjikshme përmbajtjen e deklaratave të këtyre dëshmitarëve të dhëna në Polici, duke parë se ato e mbështesin njërtjetrën dhe që çojnë në gjykimin e shprehur në dispozitiv.

Nuk gjendet asnjë kontradiktë mes arsyeve të dhëna nga Gjykata e Qarkut dhe provave të mbledhura në aktgjykimin e kundërshtuar.

Mund të shtohet se vetë *R* dhe *A* përpara Policisë e ka pranuar të jetë takuar me *I* dhe të jenë bashkuar me një grup protestuesish të cilët po hidhnin gurë drejt shtëpisë së serbit, të ketë marrë pjesë së bashku me shokët e tij në hedhjen e gurëve, ta ketë ndjekur serbin kur ai po ecte në rrugë, të kishte marrë në dorë një shkop, ta jetë ndjekur në këtë rast nga *I* dhe *A*.

- Koha për të dorëzuar aktgjykimin me shkrim është objekt i pikave të tjera të këtij arsyetimi (shih pikën I.3 dhe III.4).

- Ankesa nuk paraqet ndonjë tregues lidhur se me faktin se cilat dokumente nuk janë përkthyer, të cilat kanë ndikuar në përkeqësimin e mbrojtjes.

Në këtë mënyrë, kjo pikë duket se është e përgjithshme.

Për më tepër, mund të vihet re se në dosjen e lëndës ekzistojnë përkthimet e procesverbaleve të gjykimit kryesor dhe të gjitha dokumentet e tjera proceduriale.

2. Shkelje e ligjit penal, Neni 404 i KPPPK, si:

- pamundshmëria e bashkëekzistencës në të njëjtën kohë e veprës penale të parashikuar me anë të Nenit 146 të KPPK dhe e veprës penale të parashikuar me anë të Nenit 200 të KPK, siç është konfirmuar nga Gjykata.

NL Ankesa e konsideron si të pasaktë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për të dënuar edhe për akuzat e kryerjes së veprës penale të Vrasjes së Rëndë edhe për pjesëmarrjen në një grup që kryen vepra penale.

Meqë "është e pamundur të kryhen dy vepra penale në të njëjtën kohë" mbrojtja konsideron se Gjykata e Shkallës së Parë duhet të zgjidhte mes këtyre dy akuzave.

Kjo pikë e ankesës është analizuar më sipër (shih pikën I.2) dhe është konsideruar si e pabazuar.


3. Verifikim i gabuar dhe i paplotë i gjendjes faktike

Bazat e kësaj ankese janë si më poshtë vijon:

- Gjykata nuk i ka marrë në konsideratë deklaratat e dhëna nga dëshmitarët dhe të pandehurit gjatë gjykimit kryesor, kur ato e kanë përjashtuar *NL* nga çdo lloj përgjegjësie,

- prova të tjera materiale dhe ekspertiza shkencore e kryer tek rrobat dhe ~~kepuçet~~ të pandehurit e përjashtojnë pjesëmarrjen e tij në ngjarje, por këto elemente vendimtare nuk janë konsideruar nga Gjykata,

- sjelljen e tani të ndjerit *SP*; si përfaqësim të një rreziku për turmën e protestuesve, nuk është vlerësuar nga Gjykata.



Kjo Gjykatë nuk ndan të njëjtin mendim me ankuesin.

- Siç është shqyrtuar edhe më sipër tashmë (shihni pikën III.1) Gjykata e Shkallës së Parë ka treguar qartësisht se cilat prova janë konsideruar të qëndrueshme dhe cilat janë konsideruar të paqëndrueshme.

Gjyqtari i parë ka preferuar deklaratat e dhëna nga të pandehurit përpara Policisë, se sa provat e tjera.

Procedura e logjikshme që është ndjekur nga gjykatësi i parë tregohet në faqen 41 të aktgjykimit të kundërshtuar: për shkak të situatës së sigurisë Policia mund të procesonte vendin e ngjarjes vetëm pesë ditë pas ngjarjeve.

Pavarësisht nga numri i njerëzve që kanë qenë dëshmitarë të ngjarjeve Policia nuk mundi të mbështetej në ndihmesën e qytetarëve në lidhje me identifikimin e kryesve të vërtetë të veprës penale.

Madje ka pasur edhe një apel publik duke u bërë thirrje dëshmitarëve të ndihmojnë në hetime, por askush nuk erdhi.

Dëshmitarët që u paraqitën në Gjykatë lanë të kuptohej se ata nuk kishin ardhur me dëshirë për të dëshmuar.

Gjykata konsideroi versionin e parë të fakteve të dhëna nga të pandehurit në Polici si burimin më të besueshëm të informacionit.

Kjo Gjykatë (shihni më sipër, pika I.1.8) ndan vlerësimin e gjykatësit të parë, duke konsideruar se deklaratat e para kanë qenë autentike, jo të përpunuara nga njohuritë në lidhje me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, dhe as nga njohuritë në lidhje me deklaratat e mëvonshme dhe qëllimi thjeshtë mbrojtës.

Lidhur me sjelljen e ^{NC} dhe ^{AA} i, deklaratat e dhëna nga / ^{AI} përpara Policisë mund të kompletohen përmes deklaratave të dhëna në të njëjtat rrethana nga vetë i pandehuri.

^R I ka pranuar të ketë qenë prezent gjatë trazirave, së bashku me ^A dhe ^{SP} të ketë qëlluar me gurë në drejtim të shtëpisë së viktimës, ta ketë ndjekur ^{SP} in duke mbajtur një shkop në dorë. ^I

Të gjithë këta elementë janë të qëndrueshëm me njëri-tjetrin në kuptimin e shprehur me anë të aktgjykimit të gjykatësit të parë.

- Sa për rezultatet e ekspertizës së kryer në rrobat dhe këpucët e ^R, mund të vihet re se ky i pandehur është marrë në pyetje nga Policia më 6 prill 2004, që është 20 ditë pas ngjarjeve.


Që ai, më 17 mars ka veshur rroba dhe këpucë të caktuara, është vetëm supozimi i tij që nuk gjen mbështetje.

Për më tepër, përpara marrjes në pyetje nga Policia, ^R i mund të ketë pasur gjithë kohën në dispozicion për t'i pastruar rrobat dhe këpucët.

- Sjellja e ^{SP} luke ccur në rrugë me një armë Kallashnikov në duar, nuk mund të konsiderohet jashtë kontekstit të përgjithshëm të ngjarjeve të asaj dite.

Ai doli nga shtëpia e tij pasi kjo ishte sulmuar me dhunë nga një turmë e madhe dhe e inatosur që gidiste dhunshëm me gurë.

^A kujton veçanërisht se gjatë këtij sulmi mbi shtëpinë ai e ka parë burrin serb të shihte nga dritarja e shtëpisë.



Kur më në fund Periçi doli nga shtëpia atij po i rridhte gjak nga koka, shenjë kjo që hedhja e gurëve në drejtim të shtëpisë kishte arritur gjithashtu edhe trupin e viktimës. Periçi e përdori armën për të mbrojtur veten gjatë një veprimi që mund të konsiderohet si tërheqje.

Ai nuk qëlloi, siç është konfirmuar nga dëshmitarët dhe nga numri i plumbave që u gjetën në karikatorin e armës disa ditë më vonë.

Ai ishte i rrethuar nga e njëjta turmë e madhe dhe e inatosur, që kishte sulmuar shtëpinë e tij dhe e kishte lënduar atë.

Sjellja e tij nuk mund të konsiderohet si një rrezik i paligjshëm për turmën e protestuesve, por vetëm si një mjet i nevojshëm mbrojtjeje. Ai ishte nën një sulm të paligjshëm, të vërtetë e që po ndodhte, dhe veprimi i tij (për të kërcënuar turmën me qëllim që të dilte prej saj) ishte proporcional, deri në shkallën e atij rreziku (Neni 8 KPPK).

Sjellja e ^{SP} k e justifikonte atë të turmës, dhe as nuk përbën një rrethanë lehtësuese për kryesit e veprës.

4. Vendimi në lidhje me dënimin, si:

- paligjshmëria e dënimit.

Gjykata e parë i ka marrë në konsideratë si rrethanat rënduese (shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës penale, rrethanat e veçanta, mënyrën brutale të kryerjes së veprës, seriozitetin e veprës penale) dhe ato lehtësuese (sjelljen e mëparshme, faktin që i pandehuri nuk ka kryer vepra penale më parë, moshën e re, rrethanat personale dhe familjare të tij), dhe ka caktuar dënimin për veprën penale të Vrasjes së Rëndë për pesëmbëdhjetë vjet dhe për veprën penale të paraparë me anë të Nenit 200.1 KPK, në dy vjet e gjashtë muaj.

Në këtë mënyrë dënimet janë përcaktuar afër minimumit.

Dënimi unik u përcaktua në gjashtëmbëdhjetë vjet burgim.

Në bazë të Nenit 64.1 të KPPK dënimi do të përcaktohet duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe ai do të jetë në proporcion me seriozitetin e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit të veprës penale.


Kjo Gjykatë i ndan vlerësimet e bëra nga gjykatësi i parë në lidhje me ekzistencën si të rrethanave rënduese, ashtu dhe të rrethanave lehtësuese.

Këtij të pandehuri mund t'i atribuohet gjithashtu si rrethanë lehtësuese, rrethana lidhur me vonesën e madhe të dorëzimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Megjithatë, serioziteti i veprës penale dhe motivet lidhur me urrejtjen kundër një etnie të ndryshme, janë kaq të larta, sa për të triumfuar mbi ndonjë rrethanë lehtësuese.

Sasia e dënimit do të mbetet e njëjtë, me atë që është përshkruar nga Gjykata e Shkallës së Parë, edhe pse kualifikimi ligjor i veprës penale të Vrasjes së Rëndë, duhet parë në Nenin 30, Paragrafi 2, Pika 5 në KPK, dhe jo në Nenin 146 dhe 147, Pika 5 të KPPK.

Në këtë rast dënimi i aplikuar prej (pesëmbëdhjetë vjetësh) bie nën terma ligjore që parashikohen me anë të ligjit të aplikuar.



5. Duke i pasur parasysh të gjitha këto, dhe duke bërë përjashtimin lidhur me kualifikimin logjir të veprës penale së Vrasjes së Rëndë, Gjykata e Shkallës së Dytë vendos ta refuzojë pjesën e mbetur të ankesës së ushtruar në emër të të pandehurit !

NR

IV

Ankesa e z. Shemsedin PIRAJ dhe z. Masar MORINA, si avokatë mbrojtës të të pandehurit XJ është dorëzuar më 7 dhjetor 2006.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë kundërshtohet lidhur me:

- shkelje themelore të procedurës penale,
- shkelje të kodit penal,
- verifikimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike, dhe
- vendimit lidhur me sanksionin penal.

Avokatët mbrojtës propozojnë:

- të hidhet poshtë aktgjykimi dhe çështja të dërgohet për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë, ose
- të shqiptohet një dënim më i butë, ose
- të mbahet një seancë e cila do të përcaktojë që veprimet e të akuzuarit në fjalë, nuk përbajnë elementë të veprës penale për të cilën ai është shpallur fajtor.

1. Vërejtje paraprake të kërkesës lidhur me mbajtjen e një seance.

Duhet vënë re se ankesa nuk i tregon bazat për të kërkuar një seancë, ku do të përsëriten provat e administruara në gjykimin kryesor.

Në përmbajtjen e tij ankesa e kundërshton aktgjykimin si për sa i përket gjendjes faktike dhe arsytimit ligjor, duke deklaruar se Gjykata e Shkallës së Parë nuk i ka vlerësuar si duhet provat e mbledhura, por nuk tregon se për cilat prova bëhet fjalë, dëshmi, deklarata të pandehurish apo prova materiale të cilat duhen përsëritur, me qëllim që të arrihet një përcaktim i saktë i gjendjes faktike.

Siç është shprehur ("të përsëriten provat e mëparshme të administruara dhe të dorëzohet një vendim i saktë lidhur me këtë çështje") kjo do të thotë të përsëriten të gjitha provat.

Për këtë arsye kjo kërkesë është e përgjithshme dhe e papranueshme.

Bazat e ankesës janë si më poshtë vijon.

2. Shkelje themelore të procedurës penale, si:

- paqartësi në dispozitiv dhe paqëndrueshmëri mes tij dhe pjesës arsyetuese,
- mungesë konsiderate për faktet vendimtare,
- arsyet e dhëna janë të paqarta dhe kundërshtojnë përmbajtjen e provave të administruara.

Kjo bazë e ankesës zhvillohet në pikat e mëposhtme.

- Ankesa e konsideron dispozitivin si obskurantist, sepse ai nuk i garteson rrethanat, mënyrën dhe veprimet e drejtëpërdrejta, përmes së cilave i pandehuri do ta kashtë ndihmuar NR në privimin e jetës së ! SP.



I njëjti obskurantizëm aludohet të jetë prezent edhe në pjesën e dispozitivit që lidhet me pjesëmarrjen në një grup që kryen vepra penale.

Kjo pikë është e pabazuar.

Këtu diskutimi kufizohet në lidhje me formulimin e dispozitivit, ndërsa pikat që lidhen me përmbajtjen e arsytimit, do të shqyrtohen më tej.

Sa për ndihmesën në Vrasjen e Rëndë, duhet vënë re se dispozitivi nuk është fare obskurantist dhe duhet të lexohet në tërësi, të paktën lidhur me përcaktimet e Akuzës I, e cila është nën shqyrtim.

Prandaj, është e qartë se ngjarjet për të cilat akuzohet i pandehuri kanë ndodhur në Gjilan, më 17 mars 2004, kur Slllobodan Periçi është sulmuar nga një turmë e madhe e inatosur.

Po ashtu është e qartë se Gjykata e Shkallës së Parë e ka konsideruar ^{NR} si përgjegjës për veprimin e drejtëpërdrejtë të privimit nga jeta të viktimës, ndërsa vepronte me egërsi dhe në mënyrë të dhunshme, duke e goditur viktimën me një shkop e duke u hedhur mbi trupin e tij, ndërsa anëtarët e tjerë të turmës përreth, e kanë sulmuar gjithashtu Periçin me shkopinj të drunjte dhe gurë.

Të gjithë këta elementë nërfaqësojnë rrethanat faktike të veprës penale për të cilën akuzohet.

Sjellja e të pandehurit është përcaktuar si ndihmesë e qëllimshme në privimin e jetës së viktimës.

Sjellja reale e ^S është përshkruar si "heqja nga vendi i ngjarjes së "Kallashnikovit" që kishte ^{SP} të posedim në kohën e sulmit".

Mënyra e akuzimit në ndihmesën për vrasje, është përshkruar si privim nga arma të viktimës, "që ai e kishte përdorur më parë që të mos e lejonte turmën ta sulmonte", kjo do të thotë të privosh viktimën nga mjetet e vetme të mbrojtjes së vetvetes.

Sa për veprën penale të paraparë me anë të Nenit 200.1 të KPK, dispozitivi (A2) përshkruan një grup që "përmes veprimit të përbashkët i merr jetën Slllobodan Periçit, duke shkaktuar lëndime të rënda trupore mbi Anka Periçin dhe dëmtime të konsiderueshme" ndaj pronës së tyre.

Në këtë rast, sjellja e përshkruar më sipër e të pandehurit përfaqëson qartësisht pjesëmarrjen e tij në këtë grup dhe në të gjitha këto fakte.

Arsyeja është se ^S nori pjesë të drejtëpërdrejtë në një pjesë të këtij "veprimi të përbashkët" duke pasur dijeni lidhur me trazirat më të përgjithshme në Gjilan dhe lidhur me aktet specifike të dhunës, të cilat po kryheshin në atë pjesë të kufizuar të qytetit, pranë parkut të qytetit.

- Ankesa deklaron se të drejtat e të pandehurit janë shkelur nga sjellja e Prokurorit, pasi është dorëzuar më 28 shtator 2004, një aktakuzë e parë (ku i pandehuri ^S nuk është akuzuar për veprën penale të Vrasjes së Rëndë) dhe më 12 maj 2005 është dorëzuar një aktakuzë e përmirësuar (ku ^{AI} ^{NR} janë akuzuar për veprën penale të Vrasjes së Rëndë, në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me të tjerë), me gojë duke e zgjeruar aktakuzën dhe duke përfshirë edhe veprën penale të ndihmesës në kryerjen e Vrasjes së Rëndë, sipas Neneve 146, 147 dhe 25 të KPPK.



Ankesa deklaron se në këtë mënyrë nuk është e mundur të vlerësohet arsyeshmëria e aktakuzës që të përgatitet mbrojtja.

Kjo pikë është e pabazuar.

Që nga aktakuza e përmirësuar më 12 maj 2005 dhe nga shpjegimi *gojor* lidhur me përmirësimet që janë dhënë nga Prokurori Publik në seancën e datës 11 maj 2005, rrjedh që akuza e Vrasjes së Rëndë në bashkëpunim (sipas Nenit 22 të KP RSFJ dhe Nenit 23 të KPPK) është ngritur kundrejt katër të pandehurve, në mes të të cilëve ka qenë gjithashtu edhe *XJ* ndërsa më parë ai nuk ishte akuzuar për këtë vepër penale.

Leximi i aktakuzës përshkruan sjelljen e këtij të pandehuri si më poshtë vijon:

“ *XJ* mori nga vendi i ngjarjes një Kallashnikov që Sllobodan Periçi e kishte në posedim menjëherë përpara ose në kohën e kryerjes së sulmit”.

Pjesa e mëposhtme i referohet sjelljes së të katër të pandehurve, ku shpjegohet:

“me veprimet e njërit apo më shumë prej këtyre të pandehurve duke dhënë rezultatin e inkurajimit të turmës përreth që ata pastaj ta sulmonin Sllobodan Periçin, edhe me shkopinj dhe/apo me gurë dhe ku sulmi i të pandehurve dhe të tjerëve shkaktoi vdekjen e Sllobodan Periçit”.

Në shpjegimin e saj *gojor* Prokurorja ka treguar se sjellja e të pandehurit të akuzuar *SJ* e ka privuar viktimën nga i vetmi mjet mbrojtës, që ka çuar në inkurajimin e turmës përreth për ta sulmuar Periçin.

Nuk ka asnjë përmendje të ndihmesës në kryerjen e veprës penale, dhe as të asaj që përshkruhet në Nenin 25 të KPPK.

Në seancat në vazhdim, Prokurorja nuk e ka përmirësuar sërish aktakuzën lidhur me të pandehurin *SJ*.

Në këtë mënyrë pozicioni i Prokurores ka qenë i qartë: *SJ* është akuzuar për bashkëpunim në Vrasjen e Rëndë.

Ishte Gjykata e Shkallës së Parë që ka vendosur se sjellja e provuar e këtij të pandehurit do të kualifikohet si ndihmesë, në bazë të Nenit 25 të KPPK dhe jo si bashkëpunim, në bazë të Nenit 23 të KPPK (faqet 3, 49, 53 dhe 56).

Bazat për një kualifikim të tillë do të diskutohen më poshtë.

Këtu duhet qartësuar se nuk ka pasur ndonjë shkelje në lidhje me të drejtën e mbrojtjes.

3. Shkelje e kodit penal.

Kjo bazë e ankesës zhvillohet në pikat e mëposhtme.

- Ankesa debaton shkeljen e Nenit 25 të KPPK nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, sepse veprimet e të pandehurit nuk mund të përfshihen në dispozitën e ndihmesës, si të lexuar me anë të atij neni.

Këtu mund të shqyrtohet vetëm kualifikimi ligjor i sjelljes së gjykatësit të parë, e cila është konsideruar si e provuar, ndërsa rindërtimi i situatës faktike, do të shqyrtohet në paragrafin tjetër.

Në këtë kuptim kjo pikë e ankesës është e pabazuar.

Nga deklaratat e *AF* dhe të vetë *SJ* del se ky i pandehur ia mori armën viktimës, *SJ* dhe cila kishte rënë përtokë disa metra larg viktimës.



Arma kishte rënë përtokë si pasojë e një goditjeje të parë mbi viktimën nga turma e inatosur që ishte përreth.

Pasi u mor arma, turma e sulmoi dhe së fundmi e vrau serbin.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë (faqja 49) shpjegon se duke hequr armën, ka lehtësuar këtë sulm të pashoq kundër viktimës, i cili në atë moment nuk kishte asnjë mjet për vetë-mbrojtje. Kjo ka çuar drejtëpërdrejtë në vrasjen brutale të Sllobodan Perçit nga turma.

Në këndvështrimin juridik vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk shkel dispozitat e ligjit penal siç pretendohet nga ana e mbrojtjes.

Ajo që Gjykata e Shkallës së Parë ka parë të arsyeshme si të provuar në këtë lëndë ka të bëjë vetëm me sjelljen e një personi i cili vepron “duke larguar pengesat për kryerjen e veprës penale”, e cila është pikërisht një nga rastet e parashikuara në Nenin 25 KPPK-së në lidhje me ndihmën për kryerjen e një vepre penale.

Deri në momentin që arma ishte në rrezën e veprimit të viktimës kjo mund të ishte një pengesë për sulmin, pra sapo kjo u largua (“pas gjithë kësaj” thotë turma nisi të qëllonte Serbët me gurë dhe shkopinj.

Meqënëse largimi i pengesave nuk konsiderohet nga ligji si bashkëpunim në kryerjen e një vepre penale, Gjykata e Shkallës së Parë duhet të zbatonte nenin 25 të KPPK-së.

- Ankesa argumenton se dënimi për pjesëmarrje në një grup, sipas nenit 200 paragrafi 1 LPK-së nuk është provuar, pasi i pandehuri ishte në qytet “rastësisht”, për më tepër ai nuk iu bashkangjiti grupit me vetëdije dhe qëllim për të marrë pjesë bashkë me të tjerë në kryerjen e veprave penale për të cilën akuzohet.

Kjo pikë është e pabazuar.

Vendimi ndaj të cilit wshtw ushtruar ankesa (faqja 49) thekson vetëdijen e plotë si dhe pjesëmarrjen e qëllimshme të të pandehurit në grupin që ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet, të motivuar etnikisht me ndjenja të theksuara anti serbe.


Gjithashtu ashtu siç pranon edhe apelanti, një grup që kryen një akt kriminal mund të krijohet në mënyrë të ç'rregullt apo të rastësishme nga një grumbullim personash, të cilët nuk janë të organizuar më parë.

Me fjalë të tjera, nuk është e domosdoshme ekzistenca e një grupi të organizuar para fakteve, ashtu siç nuk janë të domosdoshme planifikimi apo paramendimi i këtyre.

Shumë njerëz mund të mblidhen rastësisht në momentin dhe vendin e një fakti të caktuar dhe megjithatë ata krijojnë një “grup” në kuptimin siç kërkohet nga neni 200 i LPK-së.

Elementë të rëndësishëm janë nga njëra anë vetëdija e grupit të njerëzve se do të kryejnë apo po kryen një vepër penale dhe nga ana tjetër se do të marrë pjesë në këtë krim.

Siç bëhet e qartë nga deklaratat e tij e dhënë në polici, siç është në dijeni të trazirave kundërve shtetasve dhe ndërtesave serbe që po ndodhnin në qytet në fillim të pasdites: ai pa një makinë që po digjej, një tjetër që u sulmua nga turma e cila u tërhoq vetëm pasi pasagjerët thanë se ishin shqiptarë, ai pa se protestuesit po gjuanin me gurë Kishën aty afër si edhe disa shtëpi në afërsi të ngjarjes.



Më vonë ai pa një turmë të madhe që ishte grumbulluar në parkingun e një parku dhe që po bërtiste “Serb me kallashnikov”.

Ai pa personin e gjinisë mashkullore me kallashnikov në dorë, i cili printe turmën duke treguar kallashnikovin në dorë.

Ky person me kallashnikov po përleshje me një burrë në moshë të thyer kundër N
I cili kishte një shkop në dorë.

I pandehuri pa se burri në moshë të thyer N po godisnin në kokë personin mashkull me kallashnikov.

Personi në moshë të thyer arriti që t’ia merrte armën nga dora personit tjetër dhe e hodhi armën në park, vetëm 2-3 meter larg nga vendi i përleshjes.

Në atë moment XS morri armën dhe pa se turm goditi dikë me shkopinj.

Është e qartë se i pandehuri ishte në dijeni të trazirave, të cilat ai mund ti shihte direkt.

Ai ishte në dijeni të faktit se një episod i këtyre trazirave ndodhi ndërmjet turmës një personi mashkull serb me kallashnikov.

Ai pa se turma ndoqi këtë person dhe se disa nga pjesëmarrësit e turmës filluan të përleshesh me të.

S arriti të ndiqte të gjitha momentet e përleshjes dhe pa se ky person mashkull po rrihej dhe vuri re se ai e lëshoi armën.

Të gjitha këto fakte ndodhën në afërsi apo shumë në afërsi (2-3 meter) të të pandehurit.

Pastaj ai morri armën dhe u largua.

Për këtë arsye XS ishte plotësisht i vetëdijshëm për ekzistencën e një grupi që po kryente veprime shumë të dhunshme dhe duke marrë armën ai ishte gjithashtu i vetëdijshëm për pjesëmarrjen e tij në këto veprime.

Për këtë arsye pjesëmarrja e tij në atë grup ishte e paramenduar.

- Përsa i përket armëmbajtjes së pautorizuar, apeli është i mendimit se “duke marrë parasysh vendin dhe rrethanat në të cilat është marrë arma si dhe duke ditur se kush ishte pronari i armës dhe përdoruesi i tij, ekspozimi i armës nuk do të thotë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ai është shpallur fajtor”.

Me fjalë të tjera apeli është i mendimit se posedimi i kallashnikovit nga ana e të pandehurit, largimi i armës nga vendi i ngjarjes, fshehja e kësaj arme pranë stadiumit për disa ditë nuk mund të konsiderohen si vepra penale për të cilën ai është akuzuar.


Dispozita ligjore e Seksionit 8.2 të Rregullores 2001/7 të UNMIK-ut fajëson personin për posedim arme, i cili nuk ka LA.

Në këtë rast mbrojtja nuk ka ngritur ndonjë çështje që ka të bëjë me LA-në.

Posedimi konsiderohet si një situatë faktike e fuqisë mbi një objekt që i korrespondon fuqisë faktike që ushtrohet nga poseduesi i të njëjtit objekt

Me fjalë të tjera një person i caktuar ka një objekt me vete, psh në dorë dhe ai mund ta përdorë atë i lirë nga çdo lloj fuqie faktike apo fuqie nga lart që ushtrohet mbi të njëjtin objekt nga persona të tjerë.

Nën rrethanat e përshkruara në vendimin e apeluar XS kishte fuqi faktike mbi atë armë sepse pronari i tij, PP po përleshje me turmën dhe për këtë arsye nuk ishte në gjendje të ballafaqohej me sjelljen e të pandehurit dhe gjithashtu sepse nuk kishte persona të tjerë që të mos lejonin S që ta konfiskonte atë.



I pandehuri ishte i lirë që të largohet me armën, ta përdorte apo ta fshihte këtë të fundit. Ai thjesht e morri armën në posedim pa qenë mbajtës i një LA të vlefshme për të. Kjo përbush kushtet për veprën penale për të cilën është akuzuar.

4. Përcaktimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Baza për apel është zhvilluar si në vijim.

I pandehuri ka mohuar në çdo fazë kryerjen e veprës penale për të cilën ai është dënuar, ai nuk ka qenë përfshirë në sulmin kundër ^{SP} c, dhe as në veprome të tjera të turmës, ai nuk ka marrë pjesë në turmë.

Nuk është sjellë asnjë provë konkrete për të treguar pafajësinë e tij ndërkohë që deklaratat e dhëna në polici nga ^{AT} dhe ^{NR} të pamjaftueshme për të mbështetur në dënimin e dhënë meqënëse ai i referohen vetëm hedhjes së armës dhe drejtimit të të akuzuarit.

Në atë vend kishte shumë njerëz, ishte pranë një shkolle dhe i pandehuri ishte i shqetësuar për rrezikun që paraqiste arma në duart e fëmijëve, dhe për këtë arsye ai e morri dhe çoi diku tjetër kallashnikovin.

Apeli është i mendimit se nëse Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar versionet e të pandehurit në shumë raste të ndryshme si kontradiktore kjo gjykata ka pasur për detyrë të sqaronte ndryshimet dhe të vlerësonte se cili version ishte i besueshëm.

Konkluzionet e Gjykatës së Shkallës së Parë nuk qëndrojnë pasi i pandehuri ka deklaruar se ka marrë armën nga disa persona në moshë të re dhe jo nga viktima. Ai nuk ka paraqitur si të mundshëm sulmin e turmës sepse qëllimi i tij ishte vetëm parandalimi i pasojave të rrezikshme.

Fakti i thjeshtë i marrjes së armës nuk vendos fajësinë për vrasje të rëndë, apo ndihmë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Deklarata e të pandehurit nuk është vlerësuar pavarësisht nëse ishte apo jo e rëndësishme; kjo duhet të kishte ndodhur për të sqaruar këtë rast.

Vlerësimi i deshmisë të dëshmitarëve nuk ka qenë i drejtë, të paktën arsyetimi nuk paraqet arsye të mjaftueshme dhe bindëse në lidhje me mosbesueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve okularë.

Mungesa e analizimit të provave, veç dhe bashkë çuan që Trupi Gjykses të merrte një vendim të gabuar.

Kjo pikë është e bazuar në lidhje me akuzën për ndihmë në vrasje të rëndë.

Edhe nëse teorikisht mund të pranohet se veprimet e një personi, i cili ka privuar viktimën nga mjetet e fundit që ai mund të përdorte për t'u mbrojtur, kanë pasur si efekt lehtësimin dhe inkurajimin e aktit të vrasjes në këtë rast konkret dhe duke pasur parasysh provat e mbledhura kjo hipotezë nuk është plotësisht bindëse.

Duhet të kihet parasysh se ^S nuk veproi direkt mbi viktimën; ai nuk ia morri armën nga dora ^{SP}

Në bazë të deklaratës së ^{AT} T, pasi ^S morri armën dhe u largua, fakti që turma filloi të godiste viktimën tregon vetëm një lidhje të përkohshme dhe jo shkakore midis këtyre dy fakteve.



Fakti se viktimi pranon se ka marrë armën kur kjo e fundit ka qenë 2-3 metra larg viktimës nuk tregon plotësisht se arma ishte në rrezën e veprimit të viktimës duke konsideruar turmën e madhe dhe konfuzionin e madh të momentit.

Nuk mund të përjashtohet mundësia se, në momentin kur S S po merrte armën, viktimë ishte (në çfarëdo lloj dhe në mënyrë të pavarur nga veprimet e të pandehurit) i paafte të merrte përsëri kalashnikovin në dorë për vetëmbrojtje.

Për shkak të rrethanave të momentit ekziston dyshimi i arsyeshëm në lidhje me perceptimin dhe dijenisë që S mund të kishte kur i morri viktimës mjedin e fundit të vetëmbrojtjes.

Me fjalë të tjera nuk mund përjashtohet mundësia se S veprimi duke marrë në konsideratë arsye të tjera të ndryshme.

Mund të jetë e vështirë të besohen arsyet "altruiste" që janë paraqitur nga i pandehuri dhe mbrojtja e tij, se ai ka qenë i shqetësuar mbi fatin e personave të tjerë të pafajshëm.

Mund të imagjinohet dhe një qëllim tjetër më i logjikshëm, të marrë armën me qëllim për ta përdorur apo shitur në vonë.

Sido që të jetë nuk ka provë të sigurt nga njëra anë midis lidhjes shkakore të veprimeve të S dhe vrasjes apo të qëllimit të tij, pa marrë parasysh nëse kjo është direkte apo e mundshme, për të ndihmuar protestuesit në vrasjen e P.

Mungesa e një prove të tillë në këto pika duhet të rezultojë në shfajësimin e të pandehurit për kryerjen e veprës penale të dhënies së ndihmës në vrasje të rëndë.

Në lidhje me dy krimet e tjera çështje është ndryshe.

Në lidhje me armëmbajtjen të paautorizuar kemi pohimin e të pandehurit si dhe prova të mjaftueshme që vijnë nga burime të ndryshme.

Përsa i përket veprës penale të pjesëmarrjes në një grup i cili kryen një vepër penale përgjegjësi e të pandehurit është vlerësuar në mënyrë korrekte nga gjykata e shkallës së parë duke konsideruar se në ato rrethana i pandehuri ka marrë pjesë në veprën penale të grupit gjithashtu nëpërmjet faktit të thjeshtë se ka patur në posedim armën e viktimës.


Nëse nuk mund të vendoset se ky akt ka inkurajuar konkretisht njerëzit në veprimet specifike të tyre për të privuar nga jeta S nuk mund të mohohet fakti se sjellja e S ka patur një efekt të fortë për të bindur protestuesit se ata nuk do të hasnin rezistencë dhe se mund të vazhdonin me kryerjen e dhunës.

5. Vendimi mbi dënimin penal.

Mbrojtja pretendon se dënimi është shumë i rreptë dhe se nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si statutin familjar të të pandehurit, gjendjen e vështirë ekonomike dhe faktin se ai ka qenë i vetmi që siguronte të ardhura për nevojat familjare.

Në këtë pikë gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh të dyja rrethanat, ato rënduese (si shkalla e përgjegjësisë penale, motivi për kryerjen e aktit kriminal, rrethanat speciale, peshën e veprave penale si dhe nëse i pandehuri ka qenë i dënuar më parë) dhe ato lehtësuese (si psh përfshirjen e kufizuar të tij në kryerjen e veprave penale nga turma si dhe rrethanat familjare të të pandehurit).

Pra, gjykata e shkallës së parë, përveç për dhënien e ndihmës në vrasje, përcaktoi dënimin për veprën penale të paraparë nga nenit 200.1 KLPK me dy vjet burgim dhe për veprën penale të armëmbajtjes së paautorizuar e dënoi me tetë muaj burgim.



Gjykata ka revokuar dënimin me tre muaj të vendosur nga Gjykata Komunale e Gjilanit dhe përcaktoi dënimin total njëmbëdhjetë vjet burgim.

Kjo Gjykatë ndan vlerësimet e përgjithshme të marra nga gjykata e shkallës së parë. Dënimi duhet të llogaritet duke marrë parasysh shfajësimin e të pandehurit nga vepra penale e ndihmës në vrasje të rëndë dhe kushtet e parapara nga Neni 71 KPPK për dënimin për bashkim të veprave penale.

Duhet të merren parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të vëna në pah nga gjykata e shkallës së parë dhe nga apeli, si dhe rrethanat lehtësuese që kanë lidhje me kohën e gjatë që gjykata e shkallës së parë ka marrë për të dhënë vendimin.

Sidoqoftë, pesha e veprës penale dhe motivet e lidhura me urrejtjen kundër një etnie tjetër paraqiten të jenë shumë më të rënda se ç'farëdo rrethane lehtësuese.

Duke marrë të gjitha këto parasysh Gjykata e Shkallës së Dytë kosideron si korrekt, dhe në përputhje me kriteret ligjore mbi dhënien e dënimit, konfirmon dënimet e veçanta të vendosura nga gjykata e shkallës së parë për veprat penale në pajtim me Nenin 200.1 LPK dhe për veprën penale të mbajtjes në pronësi të paautorizuar të armëve, të konfirmojë riapelimin e vendimit të Gjykatës Komunale Gjilan dhe në fund të shpallë dënimin për bashkim të veprave penale prej dy vjetësh dhe shtatë muajsh burgim.

V

Apeli i Z. Faruk BRESTOVCI si avokat mbrojtës i të pandehurit *AI* është paraqitur më datë 31 dhjetor 2006.

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë apelohehet për shkak të:

- Shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurave ligjore, neni 403 pika 12 në lidhje me nenin 396 pika 7 KPPK,
- Shkeljeve të kodit penal,
- Paraqitjes së gabuar dhe të paplotë të gjendjes faktike dhe
- Vendimit mbi dënimin.


Avokati mbrojtës propozon:

- Amendimin e vendimit dhe ridërgimin e lëndës gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Bazat për apel janë siç vijojnë.

1. Shkelje thelbësore të dispozitave të procedurave ligjore, si:

- pretendimi se ekziston mospërputhshmëri midis dispozitivit dhe arsytimit,
- mungesa arsyeve të nevojshme në lidhje me faktet vendimtare, disomos në lidhje me arsyen se pse disa prova konsiderohen si të besueshme dhe disa të tjera jo.



- papranueshmëria e deklaratave të të pandehurit në polici për shkak të shkeljes së dispozitës, neni 155 paragrafi 1 pika 1 dhe 2 në lidhje me nenin 154 pika 4 dhe 5 dhe në lidhje me nenin 153 pika 1 dhe 2 PKKKP dhe neni 6 GJEDNJ.

Pika në lidhje me pranueshmërinë e deklaratave të të pandehurit në polici është shqyrtuar dhe është shpallur si e pabazuar më lart (shih pikën I.1.7).

Shkeljet në lidhje me pretendimin se ekziston mospërputhshmëri midis dispozitivit dhe arsyetimit dhe mungesa e arsyeve të domosdoshme nuk ekzistojnë.

Vendimi i apeluar konstaton në dispozitiv se dënimi i ^{AI} vetëm për veprën penale në pajtim me Nenin 200.1 LPK dhe shpalljen të tij si të pafajshëm për të gjitha akuzat e tjera, përfshijnë edhe akuzën e rëndë për pjesmarrje direkte në vrasjen e

^{SP} Arsyetimi spjegon qartë se provat e marra parasysh në lidhje me këtë të pandehur, ekzaminimi i deklaratave të tij (faqja 39), pretendimi nga ana e tij se është ushtruar dhunë nga ana e policisë (faqet 45 dhe 46), cilat prova janë konsideruar si të besueshme dhe arsyet për zgjedhjen që ai ka bërë (faqja 41, 49 dhe 50), dhe konkluzionet mbi përgjegjësinë e tij individuale dhe bazat për shfajësimin e pjesëshëm të tij (faqja 50).

Pjesët e veçanta të vendimit të apeluar janë komplete dhe konsistente në tërësi dhe në veçanti me njëra tjetrën.

2. Paraqitja e gabuar dhe e paplotë e gjendjes faktike.

Baza për këtë apel është zhvilluar si në vijim.

I pandehuri pohon të ketë marrë pjesë në protestat masive në ditën kritike dhe të ketë hedhur njëherë në drejtim të shtëpisë së ^{SP}

Por nga ana tjetër ai mohos të ketë qenë i përfshirë në dhunën fizike që është ushtruar kundër ^S dhe ^{AP}

Apeli pretendon se deklaratat e dhëna në polici nga ^{NR} dhe ^{MA} nuk e përshkruajnë ^{AI} me objekte në dorë, ato gjithashtu nuk tregojnë se ai ka goditur viktimën me gurë apo gjë tjetër.

Për më tepër ^I shte në një pjesë të parkut kur viktimat dhe turma lëvizin drejt qendrës së qytetit dhe për këtë arsye i pandehuri nuk e ka ndjekur viktimën.

Ekspertiza shkencore që është bërë në rrobat dhe këpucët që ka paraqitur i pandehuri ka rezultuar negative, dhe kjo do të vendoste mungesën e çfarëdo lloji kontakti fizik në mes të pandehurit dhe viktimës.


Kjo pikë është e pabazuar.

Vendosja e gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë është bërë në mënyrë korrekte.

Vepra penale për të cilën i pandehuri është dënuar ka lidhje me pjesmarrje në një grup, i cili bashkarisht ka kryer vepra penale të ndryshme: privoi nga jeta shkaktoi lëndime të rënda trupore ^{AP} dhe dëmtoi në mënyrë të konsiderueshme ^{SP} shtëpinë dhe makinën e tyre.

Për të qenë përgjegjës për veprën penale në pajtim me Nenin 200.1 LPK nuk është e domosdoshme pjesmarrja e drejtpërdrejtë në kryerjen e një vepre penale nga një grup.

Kjo dispozitë ligjore dënon "thiesht pjesmarrjen" në grup.



Si në polici ashtu edhe para gjyqtarit hetues i pandehuri ka pohuar se ka hedhur gurë në drejtim të shtëpisë së familjes Peric, në polici ai ka pohuar se ka ndihmuar për të djegur makina me targa serbe.

Në polici, A ka pohuar se ai, NR dhe AI i janë bashkangjitur turmës së protestuesve dhe se se kanë hedhur gurë në drejtim të shtëpisë së viktimës.

SA; kur ne armë ishte duke ecur poshtë rrugës ai është ndjekur shumë afër nga N dhe dy persona të tjerë, pas këtyre njerëzve ishin gjithashtu të pranishëm vetë: A AI dhe të tjerë të cilët më parë kishin hedhur gurë në drejtim të shtëpisë së P.

Në polici R ka konfirmuar se ata të tre kanë hedhur gurë në drejtim të shtëpisë së viktimës.

Më vonë R ka ndjekur viktimën dhe pas R i tishin të pranishëm A dhe A I I.

Prandaj, në bazë të të lartpërmendurës provë rezultojnë se AI ka dëmtuar drejtpërdrejt pronën e P dhe se pastaj ai ka qenë pjesë e grupit i cili ndoqi dhe kërcënoi SP, fakt ky që rezultoi në sulmin kundër viktimës dhe në vrasjen e tij.

Kjo përmbush kushtet e dispozitave ligjore të aplikuara nga gjykata e shkallës së parë.

Rezultati negativ i ekzaminimit shkencor të zhvilluar në rrobat dhe këpucët I nuk bie ndesh me konkluzionet e gjkatës së Shkallës së Parë, duke marrë parasysh se rrobat dhe këpucët janë konfiskuar më datë 7 prill 2004, njëzet e një ditë pas fakteve dhe se kjo i ka dhënë atij kohë të mjaftueshme për të pastuar njollat apo gjurmët e mundshme.

3. Vendimi mbi dënimin

Ankesa pretendon se vendimi ndaj të cilit është ushtruar ankesë nuk përmend ndonjë rrethanë lehtësuese, ndërkohë që mosha e tij e re, fakti se nuk ka qenë i dënuar më parë si dhe arsimimi i ulët mund të konsiderohen si të tilla.

I pandehuri duhet në çdo rast të përfitojë lirim me kusht.

Gjykata e shkallës së parë ka marrë në konsideratë si rrethanat rënduese (psh shkalla e përgjegjësisë penale, motivet e veçanta të rrezikshme, rrethanat e veçanta si dhe mënyra brutale e kryerjes së veprës penale) ashtu edhe ato lehtësuese (ph mosha e re e të pandehurit) dhe ka përcaktuar dënimin prej dy vjetësh dhe gjashtë muajsh burgim.

Kjo Gjykatë ka të njëjtin mendim me vlerësimin e bërë nga Gjykata e Shkallës së parë. Siç është vënë re edhe më parë, në këtë rast pesha e veprës penale dhe motivet në lidhje me urrejtjen kundër një etnie të ndryshme janë shumë më të rënda se çdo lloj rrethane lehtësuese, duke përfshirë edhe kohën e tepërt që është marrë për të shpallur vendimin e shkallës së parë.

Për këtë arsye dënimi i përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë duhet të kondimohet. Vendimi për lirim me kusht nuk është kompetencë e kësaj Gjykate (neni 80.5 KPPPK).



4. Duke marrë të gjitha këto në konsideratë Gjykata e Shkallës së Dytë ka marrë vendimin për të refuzuar ankesën të paraqitur në emër të

VI

Ankesa Z. Azis R. SHAQIRI avokat mbrojtës i të pandehurit, A J është paraqitur më datë 12 dhjetor 2006.

Ndaj vendimit të shkallës së parë është ushtruar ankesë për arsyet e mëposhtme:

- Vendimi i marrë në lidhje me dënimin, neni 406 paragrafi 1 KPPPK.

Avokati mbrojtës propozon:

- Ndryshimin e vendimit dhe zvogëlimin e dënimit.

Bazat për ankesë janë si në vijim.

Dënimi është shumë i rreptë nëse krahasohet me aktet dhe karakterin e të pandehurit, i cili nuk ka goditur personalisht dikë me gurë në ditën kritike.

Ai ishte atje vetëm për kureshtje, pa ndonjë qëllim të paramenduar për të dëmtuar diçka apo për të lënduar dikë që i përket minoritetit serb.

Për këtë arsye, Gjykata e Shkallës së Parë duhet të kishte marrë parasysh rrethanat lehtësuese, që kanë të bëjnë me kushtet e jetesës të të pandehurit, dhe duhet të kishte marrë vënë një dënim më të lehtë.

Gjykata e shkallës së parë ka marrë në konsideratë si rrethanat rënduese (psh shkalla e përgjegjësisë penale, motivet e veçanta të rrezikshme, rrethanat e veçanta si dhe mënyra brutale e kryerjes së veprës penale) ashtu edhe ato lehtësuese (psh mosha e re e të pandehurit) dhe ka përcaktuar dënimin prej dy vjetësh dhe gjashtë muajsh burgim.

Kjo Gjykatë është dakord me vlerësimin që ka bërë gjykata e shkallës së parë, duke marrë parasysh, se në bazë të deklaratave të dhëna nga i pandehuri, I në fazën hetimore, veprimet e rënda pasi ai ishte i përfshirë drejtpërdrejt, i përfshirë në dëmtimin e shtëpisë së viktimave dhe në grupin i cili sulmoi në rrugë.

Siç është vënë re tashmë, në këtë rast pesha e veprës penale dhe motivet që kanë lidhje me urrejtjen kundër një etnie tjetër peshojnë shumë më tepër se çdo lloj rrethane lehtësuese, duke përfshirë edhe kohën e tepërt që ka marrë gjykata e shkallës së parë për të shpallur vendimin.

Për këtë arsye dënimi i përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë duhet të konfirmohet.

Duke marrë parasysh këto Gjykata e Shkallës së Dytë vendos të refuzojë ankesën e paraqitur në emër të



VII

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është ndryshuar pjesërisht në lidhje me lirim nga akuza të [XS] r veprën penale të dhënies së ndihmës në vrasje të rëndë dhe përsa i përket kualifikimin juridik të vrasjes së rëndë për të cilën është akuzuar [NR] ë bazë të nenit 30 paragrafi 2 pika 5 LPK.

Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë konfirmohet konfirmohet për pjesën tjetër.

Në bazë të nenit 391.5 KPPPK koha që të pandehurit kanë kaluar në paraburgim është e përfshirë në sasinë e dënimit.

Shpenzimet e procedurës së shkallës së dytë ndahen midis të pandehurve.

Në lidhje me paraburgimin [NR] dhe [XS] do të merret një vendim i veçantë, në bazë të nenit 426 dhe 393 KPPPK.

Sot më datë, 23 qershor 2009.

Ap. Kz Nr. 371/2008



Përgatitur në anglisht, gjuhë e autorizuar

Kryetari i Trupit Gjykses, ndërkombëtar
Emilio Gatti

Bashkëpunëtor Profesional, ndërkombëtar
Annette Andersen

Gjyqtare ndërkombëtare
Maria Giuliana Civinini

Gjyqtar Ndërkombëtar
Guy Van Craen

Gjyqtar Vendor
Salih Mekaj

Gjyqtar Vendor
Nesrin Lushta

MJET JURIDIK

Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet ankesë (neni 430 KPPK). Është e mundshme vetëm kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila duhet të paraqitet në gjykatën ku është marrë vendimi në shkallë të parë, brenda 3 muajsh nga shpallja e këtij vendimi (neni 451 – 460 KPPK).

